



# Raport Studimor

---

# GJETJET TONA

# FLASIN VETË...





# RAPORT STUDIMOR

---

**“Gjetjet tona flasin vetë...”**

**2022**

## **Raport Studimor**

### **“Gjetjet tona flasin vetë...”**

*Studimi është kryer në kuadrin e projektit “Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh”, i cili është një projekt studimi për veprim me pjesëmarrjen e të rinjve (YPAR1 ) i lehtësuar nga “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në bashkëpunim me Universitetin e Bedfordshire në Mbretërinë e Bashkuar*

**Dizajn dhe shtyp:  
Grafika Elzana  
Agolli  
Botues:  
Shtëpia Botuse “Univers”**

**Tiranë 2022**

# Tabela e përmbajtjes

Shkurtesa.....	5
Parathënie nga autoret .....	7
Përmbledhje ekzekutive .....	9
Përshkrim i projektit.....	11
Metodat.....	12
Hyrje .....	12
Çfarë do të thotë studim për veprim me pjesëmarrje të të rinjve... në teori?.....	12
Çfarë do të thotë studim për veprim me pjesëmarrje të të rinjve ...në praktikë?.....	13
Përse të përdoret qasja YPAR? .....	13
Një shënim për bashkëprodhimin .....	13
Etika .....	13
Rekrutimi i studiuesve bashkëmoshatarë .....	14
Si u trajnuan studiueset e reja?.....	15
Hartimi i kërkimit të udhëhequr nga të rinjtë .....	15
Kolazhet.....	16
Zhvillimi i anketës.....	17
Rekrutimi i pjesëmarrësve në studim .....	18
Mbledhja e të dhënave.....	19
Analiza e të dhënave .....	19
Kufizime.....	19
1. Gjetje dhe diskutime .....	20
1.1 Rruga e drejtësisë .....	20
1.2 Ngecjet e çështjeve dhe arsyet .....	21
1.3 Zvarritjet e çështjeve nga ana e profesionistëve .....	22
2. Besimi dhe mosbesimi.....	24
2.1 Besimi i të rinjve viktime tek institucionet .....	24
2.2 Sugjerimet lidhur me rritjen e besimit tek institucionet .....	25

<b>3. Paragjykimi</b> .....	<b>28</b>
<b>3.1 Paragjykimet që hasin viktimat</b> .....	<b>28</b>
<b>3.2 Kush nxit paragjykimin, kush paragjykon?</b> .....	<b>29</b>
<b>3.2 Efektet e Paragjykimit</b> .....	<b>30</b>
<b>4. Siguria</b> .....	<b>31</b>
<b>4.1 Siguria në institucione</b> .....	<b>31</b>
<b>4.2 Siguria në Polici</b> .....	<b>31</b>
<b>4.3 Siguria me Prokurorinë</b> .....	<b>32</b>
<b>4.4 Siguria në gjykatë</b> .....	<b>33</b>
<b>4.5 Siguria në familje</b> .....	<b>34</b>
<b>4.6 Mbrojtja e vetë familjes</b> .....	<b>36</b>
<b>5. Roli i trafikantëve në drejtësi</b> .....	<b>37</b>
<b>5.1 Metodrat dhe ndikimi i trafikantëve tek viktimat</b> .....	<b>37</b>
<b>5.2 Dënimet e trafikantëve dhe roli i mosdënimit</b> .....	<b>37</b>
<b>6. Komunikimi dhe sjellja</b> .....	<b>39</b>
<b>6.1 Sjelljet që përjetojnë si ofendues</b> .....	<b>39</b>
<b>6.2 Marrja në pyetje shumë herë</b> .....	<b>40</b>
<b>6.3 Fokusimi tek informacioni që është i vlefshëm për hetimin</b> .....	<b>41</b>
<b>6.4 Mbeshtetja për t'u ndjerë më mirë</b> .....	<b>42</b>
<b>Konkluzione dhe rekomandime</b> .....	<b>44</b>
<b>Referencat</b> .....	<b>46</b>
<b>Aneks 1. Pyetësi</b> .....	<b>47</b>

## Shkurtesa

D&E – Different and Equal ( Të Ndryshëm & Të Barabartë)

YPAR - Youth Participatory Action Research ( Kërkim për veprim me pjesëmarrje të të rinjëve)

BE – Bashkimi European

PMF – Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve



## Parathënie nga autoret

Kushdo që po lexon këtë raport është mbase duke menduar se kush jemi ne që po e shkruajmë.

Ne jemi një grup prej 6 studiuesesh të reja të organizatës "Të Ndryshëm & Të Barabartë" që duam të mbështesim të rinjtë dhe të rejtat e abuzuar dhe të trafikuar që kanë patur ose kanë vështirësi në rrugën e tyre për drejtësi. Ne duam t'i bëjmë të ditura eksperiencat e tyre dhe të sjellim ndryshim në reagimet e autoriteteve ndaj tyre.

Nga muaji janar deri në korrik të vitit 2021, ne jemi trajnuar intensivisht nga një studiuese e Universitetit të Bedfordshire dhe kemi marrë njohuri për kërkimin social, metodat e kërkimit, etikën etj..

Ne kemi marrë pjesë në të gjitha fazat e studimit: të gjitha kemi hartuar pyetësonin, një pjesë e jona ka intervistuar pjesëmarrësit, një pjesë ka analizuar informacionin e mbledhur, dhe tre prej nesh e kanë shkruar këtë raport.

Pas një pune njëvjeçare në të cilën secila ka dhënë maksimumin, ne shpresojmë të kemi përçuar si duhet mesazhet e pjesëmarrëseve të cilat na kanë besuar eksperiencat e tyre.





# Përmbledhje ekzekutive

Studimi është kryer në kuadrin e projektit "Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh", i cili është një projekt studimi për veprim me pjesëmarrjen e të rinjve (YPAR<sup>1</sup>) i lehtësuar nga "Të Ndryshëm & Të Barabartë" në bashkëpunim me Universitetin e Bedfordshire në Mbretërinë e Bashkuar.

YPAR synon "fuqizimin" e të rinjve që tradicionalisht kanë qenë "objekt" i kërkimit duke i angazhuar ata si bashkëkërkues. Duke qenë një zhvendosje nga kërkimi "mbi të rinjtë" në kërkimin "me të rinjtë", YPAR trajton pabarazitë tradicionale të pushtetit në punën kërkimore.

Studimi u krye në formën e anketës nga gjashtë vajza të reja të moshës 17-26 vjeç, përfituese të shërbimeve të "Të Ndryshëm & Të Barabartë", të cilat ndoqën një program trajnimi të përgjithshëm dhe trajnimi mbi hartimin dhe administrimin e një ankete nga muaji janar deri në korrik të vitit 2021.

Studimi anketoj në formë interviste gjithsej 18 vajza dhe gra të reja në periudhën korrik - shtator 2021. Gjetjet kryesore të studimit janë:

- Të gjithë pjesëmarrëset mendojnë se procesi i kalimit nëpër procedurat e hetimit dhe gjykimin penal mund të jetë traumatizues për të rinjtë dhe të rejtat e prekur nga trafikimi;
- Një pjesë e madhe e pjesëmarrësve mendojnë se të rinjtë e kanë ose të vështirë ose shumë të vështirë të shkojnë në Polici;
- Pjesa më e madhe mendojnë se çështjet ndaj dhunuesve ngecin në Polici/komisariate;
- Shkaqet e ngecjeve janë mungesa e fakteve, mosbesimi dhe paragjykimet;
- Niveli i besimit të viktimave tek institucionet e drejtësisë është i ulët;
- Rritja e besimit tek Policia shihet e lidhur me: trajtimin pa dhunë; mosdiskriminimin; inkurajimin; mbështetjen dhe përkujdesjen; drejtësinë dhe zbatimin e ligjit; mos riviktimizimin;
- Rritja e besimit tek Prokuroria shihet e lidhur me: moskorruptimin; mbështetjen dhe inkurajimin e viktimave; mostolerimin e shkeljes së ligjit; bashkëpunimin me Policinë; të kuptuarin e çështjes, komunikimin me viktimat;
- Rritja e besimit tek Gjykata shihet e lidhur me: marrjen e vendimeve të drejta; bashkëpunimin me institucionet e tjera, kryerjen korrekte të detyrës; mbështetjen

---

<sup>1</sup> Përdorim shkurtimin anglisht YPAR

- e viktimave; dëgjimin e viktimave para dhënies së vendimeve; të kuptuarit e informacionit, fakteve që u janë përcjellë;
- Institucionet e drejtësisë konsiderohen si paragjykuese;
  - Paragjykime mbi moshën dhe racën janë përdorur për të dekurajuar viktimën nga kërkimi i drejtësisë;
  - Gjysma e pjesëmarrësve mendojnë se të rinjtë nuk ndihen të sigurt kur janë në kontakt me institucionet e drejtësisë. Në rastin e Gjykatës, janë më shumë se gjysma;
  - Më shumë se 60% e viktimave nuk ndihen të sigurt në familjet e tyre. Pasiguria lidhet me: mosdënimin e trafikantëve; moszbatimin e urdhrave të mbrojtjes; qëndrimin e Policisë;
  - Në një pjesë të rëndësishme të rasteve, zgjidhja për mbrojtjen e familjes konsiderohet largimi i familjes jashtë shtetit;
  - 76% e të intervistuarave e kanë pasur eksperiencën në Polici ose "të keqe" ose "shumë të keqe". Ajo që i karakterizon këto eksperiencia është marrje shumë herë në pyetje, komunikimi, mosbesimi, kërkim i informacionit pa lidhje me çështjen, diskriminimi gjinor.

Mesazhet kryesore të këtij studimi për autoritetet përfshijnë:

- Profesionistët duhet të njohin vështirësitë që kanë viktimat për të kërkuar drejtësi;
- Zbatimi rigoroz i ligjit;
- Dhënia e dënimeve të merituarra për autorët;
- Dhënia e mbështetjes së duhur për viktimat;
- Informimi i publikut, sidomos të rinjve në zonat rurale për drejtësinë penale;
- Trajtimi i viktimave në mënyrë njerëzore, të ndjeshme, pa diskriminim;
- Shqyrtimi në kohë dhe brenda afateve të çështjeve;
- Trajtimi i të miturve në prani të psikologëve;
- Ndjeshmëria ndaj shkeljes së ligjit;
- Sigurimi i pjesëmarrjes dhe dëgjimit të zërit të viktimave gjatë proceseve penale;
- Largimi prej korrupsionit.

## Përshkrim i projektit<sup>2</sup>

“Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh” / “Hapat e Vegjël” është një projekt studimi për veprim me pjesëmarrjen e të rinjve (YPAR) i lehtësuar nga “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në bashkëpunim me Universitetin e Bedfordshire në Mbretërinë e Bashkuar. I financuar nga Fondacioni Porticus, projekti zgjati nga muaji korrik 2020 deri në muajin shtator 2022. Hapat e Vegjël trajnoi si studiuese të reja gjashtë vajza të reja të moshës 17-26 vjeç, përfituese të shërbimeve të “Të Ndryshëm & Të Barabartë”. Studiueset e reja u trajnuan për të mbledhur dëshmi mbi përvojat e të rinjve në drejtësinë penale për dhunën seksuale dhe trafikimin.

Megjithëse nga praktika ne e dime se, pas abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, kontaktet e të rinjve dhe të rejave me sistemin e drejtësisë penale mund të jenë problematike, përvojat e të rinjve dhe të rejave viktimat nuk janë dokumentuar kurrë në mënyrë sistematike. Problemi nuk kufizohet në kontekstin shqiptar, por shfaqet edhe në shumë vende të tjera të botës (Surtees dhe Johnson 2021, Beckett dhe Earrington 2015). Mungesa e dëshmive të informuara nga të rinjtë paraqet një sfidë serioze. Pa ato dëshmi, vështirë se sistemet e drejtësisë penale mund të ndihen përgjegjëse. Si në nivel rajonal ashtu edhe në atë ndërkombëtar është duke u pranuar gjerësisht se, për të siguruar që sistemet e drejtësisë të mbrojnë siç duhet personat më të cënueshëm në shoqëri, duhet të njohin realitetet e të rinjve dhe të dëgjohet zëri i tyre (Liefwaard 2020). “Drejtësia miqësore me fëmijët” përbën një prioritet kyç në kuadër të strategjisë së BE-së për të drejtat e fëmijës (EC, n.d).

Projekti “Hapat e Vegjël” është një nismë studimi e veçantë dhe tepër ambicioze që trajton pikërisht këtë mungesë kritike të dëshmive të eksperiencave të jetuara të të rinjve. Kërkimi i udhëhequr nga të rinjtë mbi dhunën seksuale është i rrallë (Bovarnick et al 2018) pasi ngërthen sfida të ndërlikuara etike dhe praktike dhe kërkon kohë dhe burime të shumta. Duke i vënë të rinjtë me përvoja të jetuara në qendër të të gjitha fazave të hartimit dhe zbatimit të studimit, ne shpresojmë se dëshmitë e paraqitura pasqyrojnë siç duhet, të pandryshuara, perspektivat dhe zërat shpeshherë të padëgjuar të të rinjve viktimat dhe të mbijetuar të dhunës seksuale, të cilët, edhe pse meritojnë mbështetje dhe drejtësi, shpesh ndihen të zhgënjyer nga sistemi.

---

2 Kjo pjesë e raportit së bashku me pjesën “Metodat” është shkruar nga Silvie Bovarnick

# Metodat

## Hyrje

Kjo pjesë e raportit përshkruan modelin e studimit. E nisim duke shpjeguar se çfarë do të thotë studim për veprim me pjesëmarrje të të rinjve dhe pse e përdorëm këtë qasje për studimin. Më pas shpjegojmë metodat tona të kampionimit dhe rekrutimit dhe reflektojmë mbi diversitetin e grupit të pjesëmarrësve dhe natyrën e bashkëpunimit, japim sqarime mbi rolet e ndryshme brenda ekipit të projektit dhe njohim kontributet diskrete të partnerëve të projektit. Më pas akoma, përshkruajmë procesin e trajnimit dhe të mbështetjes së grupit të gjashtë vajzave të reja të moshës 17-26 vjeç, përfituese të shërbimeve të "Të Ndryshëm & Të Barabartë" për të mbledhur dëshmi mbi perspektivat e të rinjve të mbijetuar, mbi se si ofrohen realisht shërbimet në fushat e drejtësisë penale dhe të mbrojtjes së viktimave. Pavarësisht se me mbështetjen e katër profesionistëve të trajnuar, studimi u krye prej këtyre gjashtë studiueseve të reja. Kjo pjesë ofron informacion të hollësishëm se si studiueset e reja përcaktuan pyetjet e kërkimit, se si ato zhvilluan mjetet e kërkimit, si mblodhën dhe analizuan të dhënat dhe mbyllet me dëshmitë e paraqitura në këtë raport.

## Çfarë do të thotë studim për veprim me pjesëmarrje të të rinjve<sup>3</sup>... në teori?

Ashtu si çdo studim për veprim me pjesëmarrje<sup>4</sup>, studimi për veprim me pjesëmarrje të të rinjve bazohet në pranimin se, që të përftojnë një të kuptuar të saktë të realiteteve dhe të zhvillojnë zgjidhje për çdo problem, është e nevojshme të përfshijmë ata njerëz që kanë patur këto situata e realitete. YPAR synon "fuqizimin" e të rinjve që tradicionalisht kanë qenë "objekt" i kërkimit duke i angazhuar ata si bashkëkërkues. Duke qenë një zhvendosje nga kërkimi "mbi të rinjtë" në kërkimin "me të rinjtë", YPAR trajton pabarazitë tradicionale të pushtetit në punën kërkimore. Sipas Jonathan London, YPAR "u ofron të rinjve mundësinë për t'u shprehur për atë se si e shohin ata botën, për ta imagjinuar botën ashtu siç e dëshirojnë ata në mënyrë që më pas të ndër marrin veprime për ta kthyer imagjinatën në realitet" (2006: 408).

---

3 I njohur në anglisht me shkurtimin YPAR

4 I njohur në anglisht me shkurtimin PAR

## Çfarë do të thotë studim për veprim me pjesëmarrje të të rinjve ...në praktikë?

Zakonisht të rinjtë punojnë në bashkëpunim me studiues profesionistë për të bashkëprodhuar njohuri për çështjet që ndikojnë tek vetë të rinjtë me qëllim nxitjen e ndryshimeve shoqërore. Pjesëmarrja e të rinjve në kërkime nuk ka fillim as fund, është një vazhdimësi. Projekte të ndryshme YPAR mund t'i përfshijnë të rinjtë në hartimin dhe zbatimin e kërkimit në shkallë dhe në faza të ndryshme dhe në mënyra të larmishme në varësi të asaj që është e përshtatshme dhe e realizueshme brenda një projekti të caktuar. Duke qenë se nismat me pjesëmarrje kërkojnë kohë dhe burime të shumta, ngritje kapacitetesh dhe lehtësues të aftë, të tilla nisma kërkimore prej të rinjve janë të rralla.

## Përse të përdoret qasja YPAR?

Dëshmitë për dhunën seksuale, përfshirë përvojat e të rinjve për të kërkuar mbështetje dhe drejtësi, gjenerohen kryesisht nga profesionistë dhe studiues të rritur. Kjo nënkupton që perspektivat e të rinjve ose filtrohen përmes lenteve të të rriturve, ose i mungojnë krejtësisht njohjes sonë. Kjo është problem sepse, pa kuptuar saktë se si të rinjtë i përjetojnë dhe i shohin problemet ekzistuese, vështirë të gjenden zgjidhjet përkatëse.

## Një shënim për bashkëprodhimin

Studimi me pjesëmarrje të të rinjve është zakonisht një bashkëprodhim i studiuesve të rinj dhe profesionistëve më me përvojë. Gjatë këtyre bashkëpunimeve, të rinjtë ndajnë pushtetin me të rriturit, ata marrin role të ndryshme dhe ndikojnë në nivele të ndryshme tek hartimi dhe realizimi i kërkimit. Është pra e rëndësishme të sqarojmë rolet që kanë marrë përsipër partnerët e projektit dhe të bëjmë të njohura mënyrat e ndryshme me të cilat anëtarët individualë të ekipit të projektit kontribuan në projekt. Ndonëse raporti është bashkëprodhuar nga studiueset e reja në bashkëpunim me një studiuese akademike nga Mbretëria e Bashkuar dhe tre profesioniste vendase, ai përmbledh punën e kryer prej studueseve të reja. Për të qenë transparentë, theksojmë se pjesa e hyrjes dhe metodave kërkonte më shumë të dhëna teknike dhe njohuri të literaturës përkatëse ndërkombëtare, që do të thotë se këto pjesë u zhvilluan nga anëtarët e ekipit të profesionistëve. Pjesët e gjetjeve, diskutimeve dhe përfundimeve që përbëjnë shtyllën e këtij raporti, u zhvilluan nga studiueset e reja. Anëtarët e ekipit të profesionistëve ofruan vetëm udhëzime për aspekte të veçanta, siç është struktura e raportit.

## Etika

Projekti mori miratimin etik nga Komisioni i Etikës së Shkollës së Shkencave Sociale të Aplikuara në Universitetin Bedfordshire. Hartimi i studimit me pjesëmarrje kërkonte një proces rigoroz të kërkesës për shqyrtim etik në dy faza. Në kërkesën e parë, Komisionit iu parashtruan në mënyrë gjithëpërfshirëse qëllimet, parametrat dhe procesi i pjesëmarrjes së të rinjve në studim si dhe u diskutuan konsideratat përkatëse etike. Pasi

studiueset e reja përfunduan trajnimin për studimin që do të kryenin dhe vendosën për modelin e studimit, u parashtrua kërkesa e dytë në të cilën u përvijua metoda e zgjedhur prej studiueseve të reja vepër mbledhjen e të dhënave- një anketim kokë më kokë, dhe u shqyrtuan hollësisht rreziqet përkatëse, nevojat për mbështetje të vetë grupit të studiueseve të reja si edhe të pjesëmarrësve të rinj. Më pas u krye vlerësimi i rreziqeve për të gjithë të anketuarit dhe studiueset e reja, të cilët të gjithë dhanë pëlqimin me vullnet të lirë dhe të informuar me mirëkuptimin se mund të tërhiqeshin nga studimi në çdo kohë.

Çështjet etike dhe praktike të përfshirjes së të rinjve të prekur nga trauma si studiues bashkëmohatarë dhe pjesëmarrës u trajtuan duke ofruar, për të gjithë, mbështetje fleksibël dhe të vazhdueshme. Përt'iu përgjigjur rrethanave personale dhe cënueshmërisë specifike të të gjithë të rinjve pjesëmarrës në projekt u përdor një qasje e informuar për traumat.

Etika ishte një shqetësim qendror dhe "i gjallë" në zhvillimin dhe realizimin e projektit, që shkoi më tej sesa lehtësimi i pëlqimit të informuar, respektimi i rregullores për mbrojtjen e të dhënave, konfidencialiteti, anonimatit dhe ruajtja e sigurisë së të dhënave. Qëllimi kryesor i "Hapave të Vegjël" ishte nxitja e studimit të dhunës seksuale në mënyrë etike dhe të kryer tërësisht prej të rinjve. Ne u përpoqëm të maksimizonim fushën e veprimit të të rejave studiuese, që ato të ndikonin në vendimet kyçe në lidhje me hartimin dhe zbatimin e studimit, por edhe njëkohësisht të siguronim që studimi të ishte solid dhe etik. Në përputhje me parimin udhëzues të moslëndimit dhe përfitimit (shihni, për shembull, Raportin Belmont 1978), studimi synoi të minimizonte dëmin dhe të maksimizonte përfitimet për të rejat e përfshira, duke krijuar, për shembull, mundësi për të dëgjuar dhe ngritur kapacitetet e tyre kërkimore. Ne besojmë se nëpërmjet një procesi edhe pse jo të përsosur por të zhvilluar në mënyrë bashkëpunuese, me përsëritje dhe me reflektime mbi përvojat, u arrit një nivel i lartë i pjesëmarrjes së të rinjve.

## Rekrutimi i studiuesve bashkëmohatarë

Për arsye praktike, të gjithë të rinjtë e përfshirë në studim u rekrutuan nëpërmjet "Të Ndryshëm & Të barabartë". Rekrutimi i brendshëm mundësoi kryerjen e vlerësimeve të personalizuara të rrezikut, nevojave dhe pikave të forta, si dhe ofrimin të mbështetjes së vazhdueshme dhe të përshtatur.

Kriteret e përdorura për rekrutim ishin:

- Mosha 17-26 vjeç;
- I çdo gjinie;
- Përfitues i të "Të Ndryshëm & Të barabartë" për së paku 6 muaj;
- Me eksperiencë të dhunës seksuale, trafikimit, dhe/ose shfrytëzimit;
- Me mundësi për tu përfshirë në projekt-në kuptimin e kohës, angazhimit etj;
- Vlerësuar nga procesi i vlerësimit të rreziqeve se rreziqet e pjesëmarrjes janë të menaxhueshme;

Ndonëse kontaktuam të rinj të gjinive dhe moshave të ndryshme, ne nuk patëm sukses të angazhonim një kampion të larmishëm siç kishim shpresuar. Gjashtë studiuese të reja të moshës 17-26 vjeç ranë dakord të merrnin pjesë në projekt. Ato ishin të gjitha femra

dhe, edhe pse historitë e tyre të abuzimit dhe rrethanat personale ndryshonin, ishin përfituese të shërbimeve të "Të Ndryshëm & Të Barabartë".

Të gjitha të rejat morën pjesë në sesione informuese që përshkruanin qëllimet e projektit. Parametrat e përfshirjes, rolet e tyre, përgjegjësitë, koha e pritshme e angazhimit, si dhe pagesat u ranë dakord qysh në fillim. Në të njëjtën mënyrë u veprua për rolet dhe përgjegjësitë e stafit, të cilat iu komunikuan qartë lehtësuesëve dhe studiuesve të reja që në fillim të projektit. Për t'u siguruar që implikimet e mundshme të pjesëmarrjes në projekt, si ato pozitive dhe negative, ishin të duhurat, studiueset e rejai eksploruan ato së bashku me stafin e projektit.

## Si u trajnuan studiueset e reja?

Nga muaji janar deri në korrik të vitit 2021, studiueset e reja iu nënshtruan një programi trajnimi rigoroz dhe gjithëpërfshirës që përmbante njësitë e kurrikulës bazë të përshkruara më poshtë:

1. Hyrje në kërkim social;
2. Qasje dhe parime teorike të studimit për veprim me pjesëmarrje të rinjve (YPAR);
3. Dhuna seksuale: të kuptuarit e formave të ndryshme dhe koncepteve kryesore;
4. Përkufizimi i prioriteteve dhe pyetjeve të studimit;
5. Metodatat e kërkimit: sasiore, cilësore, metodatat e përbëra dhe qasjet krijuese;
7. Etika e kërkimit;
8. Rigoroziteti shkencor;
9. Projektimi i kërkimit: identifikimi i metodave të duhura dhe grupeve të synuara;
10. Menaxhimi i projektit: përcaktimi i detyrave dhe afateve kohore

Programi i trajnimit u hartua për t'u dhënë të rejave pa trajnim apo përvojë të mëparshme kërkimore një bazë të shëndoshë teorike dhe për t'i pajisur ato me aftësitë e nevojshme për të hartuar dhe zbatuar një projekt kërkimor etik. Kurrikula u zhvillua duke përdorur materiale trajnimi të provuara dhe të testuara (shihni për shembull, Warrington 2022, D'Arcy et al nd, Peace 2020, Save the Children 2018, UNICEF 2019, YOUTHPRIZE 2018) që ne i përshtatëm posaçërisht për këtë projekt për të krijuar një program trajnimi YPAR gjithëpërfshirës dhe sistematik.

## Hartimi i kërkimit të udhëhequr nga të rinjtë

Programi i trajnimit YPAR u hartua si një modul i "të mësuarit duke bërë" që ndërthurte elementet e mësimdhënies dhe praktikës. Proçesi gjatë të cilit të rinjtë hartuan projektin e tyre kërkimor ishte një proçes me pjesëmarrje dhe me përsëritje që u mbështet nga një grup: një studiuese akademike nga Mbretëria e Bashkuar me mbi 20 vjet përvojë profesionale; koordinatorja e projektit/Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës "Të Ndryshëm & Të Barabartë" në Tiranë Shqipëri me 20 vjet përvojë në adresimin e çështjeve të trafikimit dhe shfrytëzimit dhe trainere mbi Antitrafikimin në Shqipëri; dy lehtësues, njëra prej



të cilave me eksperiencë në studime . Si rrjedhojë, studiuesit e rinj morën trajnime dhe udhëzime “në punë” për zhvillimin e komponentëve të ndryshëm të studimit.

Si hap i parë, studiueset e reja u njohën me temën e studimit. Tema e gjerë, përgjigjet e drejtësisë penale ndaj të rinjve të mbijetuar të trafikimit dhe dhunës seksuale, ishte paracaktuar, pasi ishte identifikuar më herët si një çështje me prioritet të lartë prej një grupi të rinjsh të mbijetuar në Shqipëri (Bovarnick dhe Cody, 2020). Studiueset e reja morën pjesë në një seminar për dhunën seksuale me qëllim përfundimtar të të kuptuarit të thellë të dinamikës bazë dhe koncepteve thelbësore të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual. Analiza e fushëveprimit ku jepej informacioni përkatës në lidhje me praktikën aktuale dhe politikën që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, dhunën në familje, trafikimin dhe dhunën seksuale, u përpilua nga një konsulente e kërkimit. Përmbledhja e analizës së fushëveprimit u prezantua si pjesë e trajnimit për njohjen e studiueseve të reja me praktikën aktuale dhe mjedisin politikave. Studiueset e reja më pas e përpunuan temën e studimit nëpërmjet një sërë aktiviteteve me pjesëmarrje, që përfshinë rrahjen e mendimeve për të identifikuar temat kryesore dhe një ushtrim hartëzimi për të lidhur strukturat dhe marrëdhëniet rreth këtyre temave. Studiueset e reja krijuan **dy kolazhe** për të vendosur vizualisht në hartë problematikat më të dukshme që prekin të rinjtë viktimë dhe të mbijetuar, si dhe për të identifikuar strategjitë mbrojtëse për mbështetje dhe shërim. Bazuar në këtë punë paraprake, studiueset e reja artikuluan një sërë pyetjeve kërkimore dhe i renditën ato sipas përparësisë.

## Kolazhet



Fig. 1:




Fig 2:

Pas trajnimit në një sërë metodash kërkimore sasiore, cilësore dhe krijuese, studiueset e reja zgjodhën të zhvillojnë një anketë për të nxjerrë në pah perspektivat e të rinjve në kërkimin e drejtësisë dhe mbështetjes pas trafikimit dhe dhunës seksuale. Arsyeja për përdorimin e kësaj metode ishte që duke përfshirë në studim një grup më të gjerë të të rinjve të mbijetuar, rritej përfaqësimi i gjetjeve. Metoda e anketimit u mundësoi gjithashtu studiueseve të reja që të testonin perceptimet e tyre ndaj të tjerëve, duke shtuar kështu një tjetër shtresë shqyrtimi dhe rigoroziteti.

## Zhvillimi i anketës

Me qëllim pajisjen e studiuesve të rinj me njohuritë teorike, aftësitë teknike dhe mundësitë praktike për të hartuar dhe administruar një anketë, u zhvillua një program trajnimi gjithëpërfshirës, me elemente si më poshtë:

- 1: Krijimi i anketës;
- 2: Hartimi i pyetjeve të anketës;
- 3: Zhvillimi i hyrjes dhe shpjegimi i pëlqimit;
- 4: Pilotimi i anketimit;
- 5: Administrimi i anketimit;
- 6: Analiza e të dhënave.

Manuali i trajnimit mbështetet në materiale të zhvilluara nga YPAR Hub i Universitetit të Berkeley (SHBA) (<http://yparhub.berkeley.edu/investigate-method/surveys/>). Planet e mësimi u përshtatën dhe u zgjeruan ndjeshëm për të përmbushur kërkesat e larta etike që lindin nga tema e kërkimit dhe grupi i synuar i angazhuar si studiues dhe pjesëmarrës në studim. Programi iu shtuan për shembull, seanca shtesë mbi "pëlqimin", mbrojtjen e të dhënave, konfidencialitetin dhe mirëqenien e studiuesit/pjesëmarrësit.

Për të udhëhequr studiuesit e rinj në procesin e hartimit, testimit dhe zbatimit të anketës, programi i trajnimit u ndoq nga muaji prill deri në korrik të vitit 2021, duke ndërthurur komponentët e mësimdhënies dhe praktikës. Anketa u pilotua gjerësisht në grup dhe iu nënshtrua tetë rundeve të vlerësimit të brendshëm deri në përmbushjen e kriterëve etike dhe cilësore. Procesi i vlerësimit mori parasysh kriteret e mëposhtme:

- A) Etikën: A janë pyetjet potencialisht shqetësuese apo nxitëse? A nxisin perceptime, në vend të historive personale?
- B) Qartësinë: A janë pyetjet lehtësisht të kuptueshme dhe të qarta?
- C) Mundësinë për të dhënë përgjigje: A mund të marrin përgjigje pyetjet e kërkimit?
- D) Rigorizitetin: A janë pyetjet neutrale dhe të paanshme?
- E) Përkatësinë: A pasqyrojnë pyetjet realitetet dhe prioritetet e të rinjve?
- F) Gjithanshmërinë: A përfshin anketa pyetjet më të rëndësishme? Çfarë mungon?

Anketa përfundimtare përmbledhi të dhëna demografike dhe përfshinte një sërë pyetjesh me shtjellim dhe me alternativa për të gjeneruar të dhëna sasiore dhe cilësore që korrespondojnë me temat kryesore të përshkruara më poshtë:

- A) Barrierat e aksesit në drejtësi dhe në mbështetje;
- B) Niveli i kënaqshmërisë së të rinjve me shërbimet;
- C) Praktikat e mira dhe fushat për përmirësim;
- D) Perceptimet se ku ngecin rastet në sistem;
- E) Siguria;
- F) Besimi;
- G) Praktikat e intervistimit ('marrja e dëshmimeve më të mira');
- H) Rreziqet e përsëritjes së traumës;
- I) Pandëshkueshmëria;
- J) Ide për më shumë praktika me në qendër të rinjtë dhe viktimat;

Anketa e plotë mund të gjendet në Shtojcë.

## Rekrutimi i pjesëmarrësve në studim

20 kandidatë të mundshëm u kontaktuan për të marrë pjesë në anketim.


Kandidatëve iu prezantua projekti "Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh" si një projekt me pjesëmarrjen e të rinjve me qëllim hulumtimin e perspektivave të të rinjve në Shqipëri lidhur me të kërkuarit e ndihmës dhe drejtësisë pas përjetimit të dhunës seksuale, dhe që synon të zbulojë përvojat e fëmijëve dhe të rinjve që kanë përjetuar dhunë seksuale në sistemin e drejtësisë penale dhe në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve/viktimave në Shqipëri.

Kandidatët u informuan lidhur me trajnimin e grupit të studiueseve të moshës së tyre, të cilat ishin shumë të interesuara për të përmirësuar reagimin e drejtësisë penale për viktimat e dhunës seksuale. Kandidatët u informuan se D&E do të vlerësonte shumë, nëse ata/ato do jepnin kontributin dhe do pranonin të intervistoheshin nga bashkëmoshatarët e tyre. Kandidatët u informuan se informacioni do të mbahej konfidencial dhe do të përdorej vetëm për qëllimin e hulumtimit.

Nga 20 të informuar, 18 **të rinj të cilët kanë patur eksperiencë të trafikimit** pranuan të merrnin pjesë në anketim si të anketuar. Të gjitha ishin vajza dhe merrnin shërbime nga Të Ndryshëm & Të Barabartë.

Të anketuarit i përkisnin moshës 15-25 vjeç. Grafiku më poshtë jep përbërjen moshore të grupit

**Fig. 1 Moshë e pjesëmarrësve**



Pjesa më e madhe, (10 nga 18) jetonin në Tiranë në momentin e mbledhjes së të dhënave.

Pjesa më e madhe (11) kishin ndjekur shkollën: ose kishin përfunduar shkollën 9 vjeçare, ose ishin duke ndjekur shkollën e mesme (6) ose e kishin përfunduar shkollën e mesme (2). Një ishte duke ndjekur universitetin.

Gjysma e pjesëmarrësve ishte akoma në vitin e parë të mbështetjes ndërsa gjysma tjetër ishte në vitin e tretë të mbështetjes.

## Mbledhja e të dhënave

Studiueset e reja mbledhën të dhëna gjatë periudhës korrik - shtator 2021. Ato realizuan 18 anketa në formë interviste.

## Analiza e të dhënave

Studimi përdori një qasje të "analizës me tema" (Braun dhe Clarke, 2006) si kornizë analitike për të kuptuar, përshkruar dhe interpretuar perceptimet e të rinjve për sistemin e drejtësisë penale. U identifikuan temat kryesore për të zbuluar domethënien në lidhje me përvojat e të rinjve viktimë-të mbijetuar ndaj përgjigjeve të drejtësisë penale në lidhje me dhunën seksuale dhe trafikimin në Shqipëri. Studiueset e reja zhvilluan dhjetë seminare për analizën e të dhënave duke filluar me kodimin prej një pjese të grupit. Kodimi fillestar u ri-analizua më pas në një proces të rishikimit nga koleget në grup dhe më pas u krijuan "grupe kuptimore" më të gjera. Të dhënat sasiore u ndanë në grafikë. Mbështetur në parimet e teorisë së bazuar në të dhëna (Strauss dhe Corbin 1998), u analizuan të dhënat cilësore të gjeneruara përmes kutive të tekstit të lirë dhe pyetjeve me shtjellim të anketës duke përzgjedhur citate dhe pjesë teksti për të nxjerrë në pah temat kryesore.

Për identifikimin e gjetjeve kryesore të studimit dhe hartimin e mesazheve avdokuese u përdor metoda e "pemës së problemeve dhe zgjidhjeve" (Snowdon e tjetër 2008). Këto trajtohen në pjesën e gjetjeve në këtë raport.

## Kufizime

Jemi të vetëdijshëm se madhësia e kampionit të studimit është relativisht e vogël dhe kjo ngre pikëpyetje në lidhje me përfaqësimin. Angazhimi i të rinjve të mbijetuar në studimin e dhunës seksuale është një sfidë e zakonshme, pjesërisht sepse tema është shumë e stigmatizuar dhe të mbijetuarit mund të kenë shqetësimet e tyre në lidhje me konfidencialitetin si dhe një nevojë reale për të mbetur anonimë. Duke pasur parasysh rreziqet e konsiderueshme shoqërore dhe kufizimet ekzistuese të burimeve, studimi ndjek një model ambicioz kërkimor, veçanërisht për studiuesit fillestarë. Qasja me pjesëmarrje të të rinjve siguroi që pikëpamjet e të rinjve të vendoseshin në qendër të hulumtimit. Metoda e anketimit e zhvilluar si pjesë e një procesi rigoroz u mundësoi studiuesve të rinj të testonin një sërë hipotezash dhe të nxirnin një kuptim më të nuancuar dhe më të thellë të çështjeve kryesore që prekin të rinjtë e mbijetuar. Si i tillë, studimi përfshin perspektiva të vlefshme dhe heterogjene të informuara nga përvojat e jetuara të të rinjve.




# Gjetje dhe diskutime

## 1.1 Rruga e drejtësisë

### Kërkimi i ndihmës nga Policia

Të intervistuarve u është kërkuar të përcaktojnë se sa të lehtë e kanë të rinjtë e prekur nga trafikimi të shkojnë tek Policia. Atyre u është ofruar të zgjedhin një nivel në shkallët: e kanë shumë të lehtë/shumë të kollajshme, të kollajshme, as të kollajshme as të vështirë, të vështirë, shumë të vështirë.<sup>5</sup> 11 nga 18 (61%) mendojnë se të rinjtë e kanë ose të vështirë ose shumë të vështirë të shkojnë te policia.

Fig. 2 Shkalla e Vështirësisë në Polici



Të intervistuarve u është kërkuar që, në rast se janë përgjigjur me " të vështirë " ose " shumë të vështirë", të shprehin arsyet pse mendojnë kështu <sup>6</sup>. Edhe pse 11 janë përgjigjur se të rinjtë e kanë të vështirë ose shumë të vështirë<sup>7</sup>, më shumë, 15, kanë dhënë arsye të cilat janë:

<sup>5</sup> Pyetja 2

<sup>6</sup> Pyetja nr.3: Pse mendoni që të rinjtë e kanë të vështirë ose hezitojnë të shkojnë në polici ?

<sup>7</sup> Shih më lart

- **Frika se mos paragjykohen:** "(Të rinjtë) E kanë të vështirë pasi kanë frikën e paragjyqimeve , çfarë do thonë për mua, çfarë do thonë për ngjarjen ,flas dhe për përvojën time, kjo ishte gjëja e parë që mendova, dhe frika." (E intervistuar Nr. 6);
- **Frika, kërcënimet dhe frikësimi nga trafikantët:** "E kanë shumë të vështirë sepse ajo ose mund të jetë nën kërcënimin e dikujt ose disa mund të kenë frikë për familjen e vet sepse në qoftë se ai futet në burg, nuk do rrijë pa marrë hak jashtë." (E Intervistuar Nr.11) ;"Sepse trafikantët nuk janë kapur – ata ushtrojnë presion ndaj viktimave" (E Intervistuar Nr. 14)" Frika se trafikanti do të marrë vesh që është denoncuar – dhe do ta dëmtojë(E intervistuar Nr.17);
- **Informacioni mbi injorimin dhe mosbesimin ndaj deklarimeve të viktimave më parë:** "me çfarë kam dëgjuar nuk e kanë marrë për bazë pasi dhe s'kanë dashur dhe e kanë kaluar si çështje" (E intervistuar Nr.3)";
- **Sjellja frikësuese e Policisë:** "Sepse ka raste kur janë marrë në pyetje, oficerët kanë ngritur zërin dhe të rinjtë janë trembur, kanë patur frikë" (E Intervistuar Nr.5);
- **Frika e publikimit në media dhe identifikimi:** "në momentin që ti shkon në polici çdo gjë bëhet mediatike dhe preket familja dhe shumë gjëra të tjera" (E Intervistuar Nr. 7) .
- **Mungesa e mbështetjes nga familja:** "Varet nëse kanë mbështetje familjare: si në rastin tim për shembull që nuk kam pasur mbështetje familjare" (E Intervistuar Nr.8) ;
- **Vështirësia për t'u shprehur përpara policisë:** "Normal që e kanë shumë të vështirë sepse viktimat sidoqoftë nuk mund ti shprehin ato që kanë( E Intervistuar Nr.9);
- **Mungesa e informacionit se çfarë do të ndodhë pasi shkon te Policia :** "Është e vështirë sepse nuk e dinë se çfarë do të ndodhë më pas" ( E Intervistuar Nr. 18)


Për ne është shqetësues si numri i madh i të intervistuarave që informojnë pengesa kur shkojnë te Policia ashtu edhe shumëllëshmëria e pengesave të informuara. Një tjetër shqetësim i fortë është që shkuarja në Polici, ndërsa nuk ka ndonjë efekt në kapjen e trafikantëve dhe abuzuesve, konsiderohet se ka efekt negativ në marrëdhëniet e viktimës me palët e treta, me familjen me mediat me shoqërinë.

## 1.2 Ngecjet e çështjeve dhe arsyet

Të intervistuarit janë pyetur në mënyrë direkte se ku pikërisht në sistemin e drejtësisë ata mendojnë se " ngecin çështjet".<sup>8</sup>

2 nga 18 përgjigjen me "nuk e di", 6 me "në Rajon/ Komisarjat/Polici, 4 me "në Gjykatë" 5 me "në Prokurori", dhe 1 me "aty ky fillohen".

<sup>8</sup> Pyetja 6: Në cilën prej shkallëve të drejtësisë penale ngecin çështje të të rinjve që pasi viktimizohen kalojnë nëpër sistemin e drejtësisë penale?



**Fig.4 Vendi i Ngecjes**

Tre prej të intervistuarave kanë sugjeruar edhe arsyet e "ngecjeve".

Arsyet janë:

**Mungesa e fakteve:** "Besoj mbesin aty ku është dhënë infomacioni pasi mungojnë faktet për të kaluar më tej." (E Intervistuar Nr. 6)

**Mosbesimi dhe paragjykimet:** "Ata vazhdimisht dyshojnë te ty, nuk besojnë tek fjala jote, thonë "je fëmijë", mund të të ketë shtyrë dikush tjetër për të folur, mendojnë se po gënjen duke mos pasur fakte". ( E Intervistuar Nr. 6)

Informacioni për eksperiencat e të rinjve që kërkojnë ndihmë dhe mbështetje lidhur me trafikimin dhe dhunën seksuale në sistemin e drejtësisë gjendet edhe në përgjigjet e Pyetjes 22: "Cili është mesazhi më i rëndësishëm që ju doni t'i jepni institucioneve të drejtësisë penale?"

Një prej të intervistuarave ngre çështjen e informimit, të kuptuarit dhe të arsimimit: "ato, (institucionet e drejtësisë penale) të shkojnë në më shumë fshatra për t'i informuar , pasi mungon informacioni , të drejtat e tyre nuk i njohin , pasi nuk kanë arsimin e duhur , prindërit nuk i kanë mbështetur apo besuar"( E Intervistuar Nr. 6)

Ne mendojmë që informacioni i mbledhur tregon se institucioni i Policisë është shumë i rëndësishëm për ecurinë e çështjeve. Përgjigjet na tregojnë se anketimi duhet të kishte mbledhur të dhëna lidhur me rolin e viktimave në çështjet penale, më konkretisht çfarë dinë viktimat lidhur me çfarë pritet prej tyre për mbarëvajtjen e çështjeve

### **1.3 Zvarritjet e çështjeve nga ana e profesionistëve**

Përveçse për ngecje, informacioni i mbledhur tregon se rasteve nuk u kushtohet gjithmonë kujdesi i duhur në kohën e duhur. Dy prej të intervistuarave kanë ngritur problemin e zvarritjeve nga ana e profesionistëve duke sugjeruar se rastet mund


të zgjaten sepse ato nuk prioritizohen dhe nuk avancohen siç duhet nga profesionistët e caktuar. Njëra prej të intervistuarave shprehet se: "mua më kanë thirrur mbas një vitinë gjykatë dhe më kanë thënë a do ta vazhdosh apo jo denoncimin ndaj atij personi dhe u kam thënë jo, nuk do ta vazhdoj sepse kam vazhduar jetën time dhe mos më thërrisni më sepse nuk kam kohë të vij nëpër gjykata dhe më kanë thënë okey, në rregull, e kemi mbyllur pjesën me ty nuk do të thërrasim më" .(E Intervistuar Nr. 7) E intervistuar tjetër shprehet se: " mbase ato ( çështjet ) kalojnë në të gjitha hallkat, po ka zgjatje të procesit" (E Intervistuar Nr. 17)



## Besimi dhe mosbesimi

### 2.1 Besimi i të rinjve viktima tek institucionet

Të intervistuarave u është kërkuar që të informojnë nivelin e besimit që kanë tek Policia, Prokuroria dhe Gjykata <sup>9</sup>. Atyre u është kërkuar të përdorin një shkallë me nivele nga 0 deri në 5 në të cilën 0 do të thotë "kurrfarë besimi" dhe 5 do të thotë "besim i plotë". Grafiku më poshtë paraqet në mënyrë vizuale përgjigjet. Një pjesë pothuaj e barabartë e intervistuarave ose nuk kanë fare besim ose kanë besim maksimal tek institucionet. Tre prej të intervistuarave nuk janë përgjigjur për Prokurorinë e Gjykatën, që tregon se eksperiencat e të rinjve me grupet e profesionistëve nuk janë të njëjta.



*Fig. 4 Besimi te Institucionet*

Studimi nuk mblodhi të dhëna lidhur me kontaktet e drejtpërdrejta të të rinjve të intervistuar me secilin prej këtyre institucioneve. Megjithatë, fakti që janë shprehur më shumë opinione lidhur me Policinë mund të jetë i lidhur me mënyrën si funksionon

<sup>9</sup> Pyetja 9. Nga 0 te 5, sa mendoni se i besojnë të rinjtë e prekur nga trafikimi institucioneve të Policisë,

sistemi i drejtësisë – në fillim shkohet tek Policia.

Besimi përbën një shqetësim të rëndësishëm për të rinjtë në marrëdhënien e tyre me Policinë. Kjo duket në referimin tek besimi edhe në përgjigjet për pyetjet e tjera që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me besimin, si p.sh. pyetja lidhur me sjelljet ofenduese.

Studimi kërkoi lidhur me besimin e të rinjve tek Policia por jo besimin e Policisë tek të rinjtë. Në të ardhmen do ishte me interes të mblidhej informacion lidhur me besimin që kanë autoritetet tek të rinjtë viktimë dhe rezultatet e këtij kërkimi të krahasohen me rezultatet e atij lloj kërkimi.

## 2.2 Sugjerimet lidhur me rritjen e besimit tek institucionet

Pyetja 10 nxorri opinionet e të rinjve mbi besimin: *“A keni ndonjë sugjerim se si mund të rritet besimi mes të rinjve viktimë dhe këtyre institucioneve<sup>10?</sup>”*. Ka patur më shumë përgjigje lidhur me Policinë dhe më pak për Prokurorinë dhe Gjykatat. Përgjigjet megjithatë kanë qenë të shkurtra, telegrafike.

### 2.2.1 Sugjerimet lidhur me rritjen e besimit tek policia

Pothuajse të gjitha, 16 të intervistuar, kanë dhënë sugjerime të ndryshme për Policinë. Sugjerimet kanë qenë të shkurtra por të larmishme.

- Pesë të intervistuar kanë sugjeruar që Policia duhet të kuptojë dhe besojë viktimën: *“Të na kuptojnë kur të flasim dhe të na besojnë”* (E intervistuar Nr. 13);
- Tre të intervistuar kanë sugjeruar që Policia duhet të bëjë detyrën, të zbatojë ligjin: *“normalisht një gjë kur nuk e përjeton vetë në fillim është e vështirë ta besosh dhe të jesh i saktë ose i sigurt që kjo ka ndodhur por që edhe nëse nuk ka ndodhur, ti bëj detyrën tënde si police që je ose si pmf<sup>11</sup>, si gjykatë si prokurore, si avokate ose si psikologe. Normalisht ti duhet ta aprovosh çështjen t'i japësh pro dhe atëherë nëse është e vërtetë apo jo është në dorë të dikujt tjetër që të zbulohet dhe jo ta gjykosësh tjetrin nëse është e vërtetë apo jo”* (E Intervistuar Nr.8);
- Tre të intervistuar kanë sugjeruar që Policia duhet të mbështesë, të ndihmojë, të përkujdeset për viktimat: *“ti mbajnë afër, ti besojnë, të mblidhen me persona të tjerë që ofrojnë ndihmë, për të mbështetur viktimën”* (E Intervistuar Nr. 10);
- Dy të intervistuar kanë sugjeruar që Policia duhet të jetë e vëmendshme dhe të mos bëjnë dallime: *“Që të jenë të vëmendshëm në këto lloj rastesh që të mos ketë më viktimë, të mos ketë më trafikim ...të ketë vëmendjen te të gjithë, jo vetëm te një person”*(E Intervistuar Nr.11);
- Dy të intervistuar kanë sugjeruar që Policia duhet të ketë cilësi dhe sjellje që janë të nevojshme për besim: *“...të tregojnë respekt, tu tregojnë njerëzve dhe rasteve më shumë vëmendje”* (E Intervistuar Nr. 18); *Duhet të investigojnë më shumë, të besojnë viktimën, të jenë të sjellshëm, të mos e gjykojnë* (E Intervistuar Nr. 15);
- Dy të intervistuar kanë sugjeruar që Policia duhet të japi kurajo: *“Ti mbështesin viktimat ti japin kurajo”* (E Intervistuar Nr.4);
- Dy të intervistuar kanë sugjeruar që Policia duhet të mos tolerojë, të mos

10 Policisë, Prokurorisë, Gjykatës

11 Punonjës i mbrojtjes së fëmijës

lëshojë dhunuesit: *"Të vendosin drejtësi, çdo trafikant duhet të përballet me drejtësinë, jo ta mbajnë një natë në komisariat dhe pastaj ta nxjerrin, pasi ai do trafikojë vajza të tjera"* (E Intervistuar Nr.17);

- Një e intervistuar ka sugjeruar që Policia duhet të jetë drejtë: *"Të jenë të drejtë"*

(E Intervistuar Nr. 18);

- Një e intervistuar ka sugjeruar që Policia duhet të investigojë më shumë/më mirë (1): *"Duhet të investigojnë më shumë, të besojnë viktimën, të jenë të sjellshëm, të mos gjykojnë"* (E Intervistuar Nr. 15);
- Një e intervistuar ka sugjeruar që Policia duhet të mos viktimizojnë përsëri: *"Të kenë një komunikim më të mirë, të kenë një përkujdesje më të mirë, të mos e viktimizojnë pasi ajo viktimë është, është absurde, nuk është normale"* (E Intervistuar Nr. 5);
- Një e intervistuar ka sugjeruar që Policia nuk duhet të jetë e korruptuar: *"Nuk duhet të jenë të korruptuar"* (E Intervistuar Nr. 12);

Mungesa e elaborimit të sugjerimeve lidhur me rritjen e besimit nga Policia mund të jetë e lidhur me mungesën e informacionit lidhur me detyrimet që ka policia. Mundet gjithashtu që kjo "mungesë" përgjigjesh të jetë e lidhur me kontaktet që të rinjtë pjesëmarrës në studim kanë me Policinë. Siç është informuar më lart, më shumë se gjysma kanë mbi një vit që janë në programin e Të Ndryshëm & Të Barabartë dhe që mund të kenë kaluar me kohë fazën e kontakteve me Policinë.

Edhe pse studimi nuk eksploroj në mënyrë të drejtpërdrejtë konceptin e dhunës, termi dhunë u përdor nga të intervistuarit për akte agresiviteti që përfshijnë dhunën fizike të kryer nga policia ndaj njerëzve që kërkonin mbështetje dhe drejtësi. Në rastet kur referohet tek dhuna është fjala edhe për dhunë fizike.<sup>12</sup> Në të ardhmen do të ishte me interes që të kuptohej se cilat lloje dhune ndeshen në Polici.

Besimi dhe çështje të tjera shihen të lidhura me situatën e përgjithshme të raporteve të qytetarëve me drejtësinë. Në të ardhmen do të ishte me interes të eksplorohej se si dhe në ç'masë ndikon situata e përgjithshme, raportet e qytetarëve të tjerë me drejtësisë tek raportet e të rinjve viktimë me drejtësinë.

### **Sugjerimet lidhur me rritjen e besimit tek Prokuroria**

Më shumë se gjysma, 11 të intervistuar, kanë dhënë sugjerime për Prokurorinë. Sugjerimet janë të ngjashme me sugjerimet për Policinë: Të mos jenë të korruptuar (1); Të mbështesin e t'u japin kurajo viktimave (1); Të mos tolerojnë shkeljen e ligjit (2); Të bashkëpunojnë me policinë (1); Të kuptojnë çështjen (1); Të komunikojnë me viktimat (1); Të bëjnë punën e tyre (1); Të tregohen më të drejtë me rastet (1); T'i japin rëndësinë e duhur çështjes (1).

Besimi tek Prokuroria/prokurorët është informuari lidhur me trajtimin që i bëjnë ata çështjeve. Një prej të intervistuarave shprehet: "Do e lidh prap me rastin tim, nuk u besoj

<sup>12</sup> Në përgjigje të pyetjes 16: "Çfarë mund të bëjë policia për ti bërë viktimat e trafikimit të ndjehen më mirë dhe të mbështetur në situata të tilla?" një prej të intervistuarave thotë " Mu kujtua diçka, vëllain tim kur ka qenë 12 vjeç se për çfarë e kapën natën e kanë rrahur vëllain tim ia kanë thyer gishtat , mua më vjen vetem t'i shaj policat (u prek pak te kjo pyetje dhe filloi të luante me kasën e telefonit) .(E Intervistuar Nr. 12)

atyre pasi nuk kanë bërë asgjë, dhe vazhdojnë të jenë ashtu, nuk hapin as telefonin...ata vetëm shtyjnë gjërat me javë të tëra " ja dhe një javë, ja dhe një javë"" (E Intervistuar Nr. 16)

Një nga gjërat që vihet re në sugjerimet për Prokurorinë është se, në dallim nga sugjerimet për Policinë, këtu shfaqet koncepti "çështje". Arsyet mund të jenë se "çështjet" nuk nisin në polici, ose që edhe nëse nisin, kjo nuk dihet nga të rinjtë viktimë. Ndërsa tek sugjerimet për Policinë nuk shfaqet sugjerimi që Policia të bashkëpunojë me Prokurorinë, tek sugjerimet lidhur me Prokurorinë shfaqet sugjerimi që Prokuroria të bashkëpunojë me Policinë.

### **Sugjerimet për Gjykatat**

Pak më shumë se gjysma e të intervistuarave, por më pak se për Prokurorinë, 11 të intervistuar kanë dhënë sugjerime për Gjykatat. Në afërsisht 2/3 e përgjigjeve, rritja e besimit është e lidhur me uljen e korrupsionit.

Sugjerimet janë: të marrin vendime të drejta e të japin dënime të merituar (2 të intervistuar ); të bashkëpunojnë me institucionet e tjera (2të intervistuar); të bëjnë punën/ detyrën (1e intervistuar); të mbështesin viktimat (1 e intervistuar ); të pyesin para se të japin vendimin (1 e intervistuar); të kuptojnë informacionin, faktet që u janë përcjellë (1e intervistuar).

Përgjigjet e dhëna në pyetjen për sugjerime lidhur me rritjen e besimit tek Gjykatat janë të shkurtra, telegrafike. Arsyeja mund të jetë që të intervistuarat mund ta kenë quajtur se janë përgjigjur në seksionet e mëparshme kur janë përgjigjur lidhur me Policinë dhe Prokurorinë.

Ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale kanë sanksionur të drejta të viktimës së veprës penale për informacion lidhur me çështjet. Nuk ka patur në këtë studim pyetje për të kuptuar nëse të rinjtë viktimë kanë përfituar nga këto ndryshime. Megjithatë është inkurajuese dhe shumë pozitive që sugjerimet e dhëna përkojnë me ndryshimet në raportet drejtësi-të rinj viktimë. Shtrimi i pyetjeve të tilla në hulumtimet e ardhshme do të ndihmonte krahasimin dhe do të mund të përkthehej në aksion për rritjen e besimit dhe efekte të tjera.



# Paragjykimi

## 3.1 Paragjykimet që hasin viktimat

Pjesëmarrësit nuk janë pyetur në mënyrë direkte nëse kanë patur eksperiencë të paragjyqimeve nga profesionistët dhe as se çfarë efekti ka patur kjo në aftësinë e tyre për të kërkuar drejtësi. Paragjykimi u shfaq ndjeshëm në përgjigjet e dhëna për pyetjen Nr. 3: *“Pse mendoni që të rinjtë e kanë të vështirë ose hezitojnë të shkojnë në polici?”*; dhe në përgjigjet ndaj pyetjes 22: *“Cili është mesazhi më i rëndësishëm që ju doni ti jepni institucioneve të drejtësisë penale?”*

3 nga 16 që i janë përgjigjur pyetjes Nr. 3, kanë përmendur paragjykimin si të lidhur me hezitimin apo vështirësinë për të shkuar në Polici: *“E kanë të vështirë pasi kanë frikën e paragjyqimeve, çfarë do thonë për mua çfarë do thonë për ngjarjen, flas dhe për përvojën time kjo ishte gjëja e parë që mendova”* (E Intervistuar Nr. 6); *“që në momentin që ti shkon në polici çdo gjë bëhet mediatike dhe preket familja dhe shumë gjëra të tjera dhe njerëzit paragjykojnë nga shoqëria, nga puna, është thjesht çështje mentaliteti dhe frike”* (E Intervistuar Nr. 7); *“... ( viktimat ) ndihen të paragjykuara”* (E Intervistuar Nr.15)

Në analizën e këtyre përgjigjeve doli e nevojshme të bihej dakord me grupin të studimit se çfarë përbën “paragjykim”. U ra dakord që ndërsa “paragjykim” kuptohet një mendim i padrejtë, që është formuar që më parë për dikë a për diçka pa e njohur mirë dhe që pengon për ta njohur më mirë dhe për ta vlerësuar atë me paanësi<sup>13</sup>, çdo sjellje apo mendim i quajtur “paragjykim” nga pjesëmarrësit do të konsiderohej dhe raportohej si i tillë në studim.

Llojet e paragjyqimeve të përmendura janë paragjykimet lidhur me viktimën si individ dhe paragjykimet lidhur me ngjarjen kriminale, paragjykimet nga individë apo grupe të ndryshme. Në përgjigjet del në pah edhe ndjesia që vetë të rinjtë kanë se po paragjykojnë.

Në përgjigjet ndaj pyetjes 22, *“Cili është mesazhi më i rëndësishëm që ju doni ti jepni institucioneve të drejtësisë penale?”* informohen paragjykimet për shkak të racës dhe moshës së viktimës. Një prej të intervistuarave (Nr 12) jep këtë mesazh: *“...mos i përbuzni ( viktimat) çfarë rrace janë se çfarë ngjyre janë... njerëzit me ngjyrë i përbuzin shumë në Shqipëri. Mentaliteti racizmi ekziston është ...kur të pyesin se çfarë je, kur ua thua të shohin me një sy tjetër sidomos policët, direkt fillojnë të ngacmojnë”*


<sup>13</sup> Shih edhe : <https://fjale.al/paragjykim>

Ne mendojmë se përgjigjet tregojnë se gjatë rrugës së tyre për të kërkuar drejtësi shumë gjëra janë në mendje, që mbase në shumë raste i bëjnë këto viktime të stepen e të ndalojnë dhe të mendojnë: çfarë do thonë për mua, çfarë do të thonë për ngjarjen? Me këto mendime shumë të rinj që iu është bërë padrejtësi, që janë lënduar, stepen sepse paragjykimet ekzistojnë dhe janë të frikshme dhe vetëm prej tyre shumë të rinj viktime humbasin shansin për të kërkuar drejtësi humbasin shansin që gjërat mund të ndryshojnë në jetën e tyre. Por a është e drejtë që këto viktime të humbasin të drejtën e tyre për drejtësi vetëm sepse paragjykojnë?

Mund të duket një numër i vogël që nga 18 vetëm 3 kanë përmendur paragjykimet si pengesa për të shkuar në polici por viktime nuk janë vetëm këta: diku aty jashtë ka shumë e më shumë që vetëm prej frikës së paragjykimeve nuk marrin kurajon të denoncojnë.

### 3.2 Kush nxit paragjykimin, kush paragjykon?

10 pjesëmarrësit që kanë përmendur paragjykimin në përgjigjet e tyre, e kanë bërë të qartë se paragjykimet vijnë nga anë të ndryshme/ nga individë në ambiente të ndryshme. Një nga pjesëmarrësit në studim është shprehur se ka pasur paragjytime nga familja, dy pjesëmarrës janë shprehur se ka paragjytime nga shoqëria, tre se ka paragjytime nga njerëzit në vendin e punës dhe katër pjesëmarrës se ka paragjytime edhe nga institucionet e drejtësisë. Grafiku më poshtë ilustron këto kategorizime.



*Fig.5 Kush paragjykon*

Numri i madh i të rinjve që kanë informuar se kanë vuajtur paragjykim dhe "gama" e gjerë e paragjykesve tregon një shtrirje të gjerë të paragjyimit dhe efekteve të tij. Futja e familjes në rradhën e atyre që paragjykojnë paraqet një shqetësim të madh lidhur me mbështetjen që viktimat marrin dhe mirëqenien e tyre në afat të gjatë.

Për shkak se nuk ka patur pyetje specifike lidhur me paragjykimet është e vështirë të arrish në konkluzione se cilat janë pikërisht paragjykimet dhe se si shprehen ato. Është e nevojshme që në hulumtime të tjera të përfshihen pyetje specifike lidhur me paragjykimet: nëse ato janë të lidhura me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual, nëse janë të lidhura me "narrativat" e vetë viktimave lidhur me atë që u ka ndodhur etj..

### 3.2 Efektet e Paragjykimit

Efektet e paragjykimit që informohen nga intervistat janë që paragjykimi: sjell/shton frikën; heq mbështetjen e familjes; shton hezitimin për të shkuar në Polici.

Ne konsiderojmë se përgjigjet duan të thonë se është shumë e vështirë të mendosh se si do vazhdosh të jetosh pas diçkaje që nuk e ke dëshiruar apo menduar ndonjëherë të ndodhë në jetën tënde dhe ndërkohë që përballësh me vështirësi nga më të ndryshme. Vjen momenti që përballësh dhe me paragjykimet të cilat nuk i meriton dhe prej këtyre paragjykimëve humbet veten, mbështetjen e familjes, humbet mundësinë për drejtësi, paragjykimet të shtojnë frikën për të ecur para.

Është e nevojshme që në hulumtime të tjera të përfshihen pyetje specifike lidhur me efektet që ka paragjykimi në të gjitha sferat e jetës së të rinjve pas eksperiencave me abuzimin dhe trafikimin.

Ne duhet të kuptojmë më mirë se si viktimat perceptohen dhe trajtohen nga shoqëria, nëse shmangen nga familja, komuniteti, nëse humbasin miqtë. Pyetje të tjera që mund të shtrohen mund të jenë: A do të kenë vështirësi në gjetjen e punësimit apo strehimit? A janë në rrezik më të madh të riviktimizimit në marrëdhëniet intime?


# Siguria

## 4.1 Siguria në institucione

Sipas të dhënave të nxjerra nga studimi del që shumica e të rinjve nuk ndihen të sigurt kur janë në kontakt me institucionet e drejtësisë. Vetëm një numër i vogël, 3-5 të intervistuar, informojnë që të rinjtë viktimë ndihen të sigurt në momentin që janë në kontakt me institucionet e drejtësisë.

## 4.2 Siguria në Polici

Nga 18 të intervistuar, vetëm 5 prej tyre janë përgjigjur që të rinjtë e prekur nga trafikimi ndihen të sigurt kur janë në kontakt me Policinë dhe 9 janë përgjigjur që nuk janë të sigurt kur janë në kontakt me Policinë. Një prej tyre ka komentuar që ndihen të sigurt vetëm nëse i mbron Policia<sup>14</sup>



*Fig 6 Siguria në Polici*

Të intervistuarave u është kërkuar të japin opinionin e tyre lidhur me atë që mund të bëjë Policia që ti bëjë të rinjtë të ndjehen më të sigurt.

<sup>14</sup> Nuk është konsideruar si përgjigje



Një pjesë e madhe e të intervistuarave (7) , sugjerojnë mbështetjen e viktimave prej policisë : „*Më shumë mbështetje, t'i ndihmojnë viktimat*” ( E Intervistuar Nr. 4); *“T'i mbajnë afër, t'i besojnë, t'i japin kurajo, guxim, t'i ndihmojnë për çfarëdo lloj ndihme që të kenë nevojë, viktimat ka nevojë të besohet që të flasë ”* ( E intervistuar Nr. 10).

4 prej të intervistuarave informojnë komunikimin si kusht për sigurinë: *“Policët të jenë pak më shumë komunikues, do ishte më mire”* (E Intervistuar Nr. 8); *“Të kenë komunikimin e duhur”* (E intervistuar Nr. 14); *“Për aq kohë sa problemi është komunikimi, duhet të ndryshojë dhe marrja në pyetje në prani të shumë personave”* ( E intervistuar Nr. 17); *“Të jenë të aftë të komunikojnë në mënyren e duhur, t'i kuptojnë, të sillen mirë”* ( E intervistuar Nr. 18)

Të intervistuarat e tjera theksojnë plotësimin e detyrimeve institucionale: *“Ta bëjnë punën e tyre siç duhet dhe jo të thonë është turp të denoncosh”*(E Intervistuar Nr. 1); *“Të merren më shumë me çështjet, mos t'i lenë mbas dore, jo të thonë i kemi në listë dhe s'i kanë kërkuar.”* ( E Intervistuar Nr.9).

Një prej të intervistuarave mendon se nuk mund të ketë ndryshime: *“Me këtë polici që kemi sot ne këtu asgjë nuk bëhet ”* (E intervistuar Nr. 11)

Në përgjigjet nuk gjenden sugjerime për ndryshime të ambjenteve fizike të policisë gjë që të çon të mendosh se siguria përcaktohet nga aftësitë „soft” të punonjësve të policisë. Përgjigjet tregojnë një nevojë të madhe për mbështetje- siguria buron nga mbështetja.

### 4.3 Siguria me Prokurorinë

Në kontakt me Prokurorinë 5 janë përgjigjur me „po” që ndihen të sigurt kur janë në kontakt me Prokurorinë dhe 9 janë përgjigjur me „jo”. 3 nuk kanë dhënë përgjigje dhe 1 ka komentuar që ndihet e sigurt vetëm nëse shkon në Prokurori me dikë që e ka ndihmuar.




Fig.7 Siguria në Prokurori

8 prej të intervistuarave nuk kanë sugjerime për Prokurorinë lidhur me si mund të rritin sigurinë.


Dy prej të intervistuarave sugjerojnë që Prokuroria të bëjë punën: *„ta bëjnë punën e tyre siç duhet”* ( E Intervistuar Nr.1); *“Të bëjnë punën e tyre, mos t’i zgjasin gjërat, mos t’i shtyjnë”* ( E Intervistuar Nr. 14). Një pjesë tjetër sugjerojnë mbështetjen dhe vëmendjen: *“Më shumë mbështetje, ti ndihmojnë viktimat”* (E Intervistuar Nr. 4); *“Duhet ti mbështesin pafund. duhet të kenë mbështetjen maksimale”* (E intervistuar Nr. 12); *“Prokurorët t’u kushtojnë vëmendje më shumë të rinjve”* (E intervistuar Nr. 9).

Një prej të intervistuarave shprehet se Prokuroria është në pozitë më të mirë sesa Policia për të kuptuar çështjen dhe sigurinë lidhur me të: *“Prokurorët janë në djeni të çështjes... dhe e kanë më të lehtë të të kuptojnë”* ( E Intervistuar Nr. 8)

Një numër më i ulët i sugjerimeve për Prokurorinë sesa për Policinë mund të tregojë që të intervistuarat mendojnë se nuk mund të ndryshohet gjë në lidhje me sigurinë në Prokurori , ose që nuk kanë patur eksperiencë në Prokurori.

#### 4.4 Siguria në gjykatë

Në kontakt me gjykatësit, 3 prej të anketuarve janë përgjigjur me „po” që ndihen të sigurt, 10 janë përgjigjur me „jo” që nuk ndihen të sigurt kur janë në kontakt me gjykatësit.



**Fig.8 Siguria në Gjykatë**

8 prej të intervistuarave nuk kanë sugjerime për gjykatën. 10 të intervistuarat që kanë dhënë sugjerime kanë theksuar:

- Plotësimi i detyrimeve si institucion: *“ta bëjnë punën e tyre siç duhet”* (E Intervistuar Nr. 1);

- Mbështetja: *"Më shumë mbështetje, ti ndihmojnë viktimat"* (E Intervistuar Nr. 5) ti mbrojnë ( Respondent no 2);
- Respektimi i privatësisë: *"Gjykatësi të mos bëjë pyetje që s'duhen bërë, që më ka ndodhur të më bëjnë. ... Në fazën që unë kisha gjyqin atij nuk I duhej fare që të dinte pjesën e historisë time, ku do të qëndroja te mami apo këtu ( me organizatën) Ai bënte pyetje mbi historinë time. Normalisht që kjo nuk është detyra e tij që të bënte pyetje ndaj meje se çfare ka ndodhur me mua"* ( E Intervistuar Nr. 8 );
- Bashkëpunimi mes institucioneve: *"Gjykatësit të bashkëpunojnë me njërin tjetrin"* ( E Intervistuar Nr. 11)
- Të japin drejtësi: *"Të gjykojnë çështjen me drejtësi për atë çka ka ndodhur me viktimën"*. (E Intervistuar Nr. 14); *"Të jenë të drejtë"* (E Intervistuar Nr.18);
- Të jenë të ndjeshëm: *"Të jenë më korrekt, më të ndjeshëm, të mendojnë se po ndihmojnë dikë dhe ligjin në të njëjtën kohë, të mendojnë se kanë fëmijë vet"*( E Intervistuar Nr.15)

Një numër i tillë shqetësues i viktimave të pasigurta në institucione duhet marrë në konsideratë nga të gjithë dhe të mendohet pyetja përse këta të rinjë janë përgjigjur me jo, që nuk ndihen të sigurt kur janë në kontakt me këto institucione që detyra e tyre është ti dëgjojë e ti mbrojë këta të rinj. A është dicka që nuk shkon si duhet, që në vend që të rinjtë ti besojnë e të ndihen të sigurtë nga këto institucione kanë frikë?

#### 4.5 Siguria në familje

Kur të intervistuarat janë pyetur se nëse ndihen të sigurt kur kthehen në familjen e tyre, 12 janë përgjigjur „jo” , 3 janë përgjigjur me „as po as jo” dhe vetëm 3 prej tyre janë përgjigjur me „po”




Fig.9 Siguria në familje

Në përgjigje të kësaj pyetje me zgjedhje, dy nga të intervistuarat janë shprehur më tej që viktimat do të ndihej më e sigurt kur të shkante në familje nëse: do të kishte urdhër mbrojtje, mbështetje; do të ishin kapur personat keqbërës; do të ishte e sigurtë që nuk do bëhej më keq, kur të ishte e sigurt që ishte e zonja të përballej me çdo lloj sfide.

Të intervistuarit janë pyetur specifikisht se çfarë se do ta rriste sigurinë e të rinjve pasi janë kthyer në familjet e tyre.<sup>15</sup>

Në përgjigje të kësaj pyetje , dy nga të intervistuarit informojnë për probleme të mbrojtjes në familje : *"Mbështetja e policisë është primarja por në disa raste nuk është se funksionon, flasim për në Shqipëri gjithmonë."* (E Intervistuar Nr. 8); *"Policia vetëm thotë shkoni, jeni të sigurt te familja juaj asgjë tjetër nuk bën vetëm thotë një fjalë goje, s'do t'ja dijë se çfarë të ka ndodh më vonë, nëse je gjallë a jo"*( E Intervistuar Nr. 9).

Një prej të intervistuarave shprehet se qëndrimi me familjen do ishte i sigurt *"sepse askush nuk mund të ndihmojë sa familja, as policia"* (E Intervistuar Nr. 9).

Masat që do ta bënë më të sigurt qëndrimin në familje informohen se janë:

- Dënimi i trafikantëve – informohet nga 4 të intervistuarat: *"Për sa kohë që trafikanti është i pa dënuar, është i frikshëm kthimi në shtëpi"* (E Intervistuar nr. 16); *"Kam dëgjuar që shumë vajza nuk ndihen të sigurt në shtëpi. Jo në qoftë se trafikantët nuk janë dënuar"*(E Intervistuar Nr. 17); *"Të jenë kapur personat keqbërës, të jete e sigurt që nuk do bëhet më keq , kur ajo është e sigurt mund t'i bëjë ballë çdo lloj sfide ,t'i japë kurajo , që ajo më vonë të ndihmojë viktimat të tjera"*(E Intervistuar Nr.10); *"Personi që ka kryer krim mos të lirohet pas 10 ditësh por t'i jepet një mesazh i mirë personit që bën kërcënimin në mënyrë që as ai mos ta provojë më"*(E Intervistuar nr. 7); *"Të kapen trafikantët, kjo është gjëja kryesore. Mendoj se ata duhet të rehabilitohen, të ndryshojnë dhe kështu nuk do kërkojnë hakmarrje kur të dalin"* (E Intervistuar Nr.14).
- Lëshimi dhe zbatimi i urdhrave të mbrojtjes- 3 të intervistuarat: *"Mendoj se duhet të kenë mbrojtje nga policia, urdhër mbrojtje por jo thjesht një letër por të jetë me vepra"* (E Intervistuar Nr. 7)
- Veprimet, qëndrimet , masat e Policisë– 5 të intervistuarat: *"Duke këshilluar viktimën të rrijë larg personave që e lëndojnë , t'i ofrojnë një ambient të qetë në familje, me njerëz të sigurt që e ndihmojnë që të mos ketë mendjen tek ajo çfarë ka ndodhur"*( E Intervistuar Nr. 6); *"Unë them që të vendosin roje siç është edhe jashtë shtetit"* ( E Intervistuar nr. 11); *"Për sa kohë policia punon mirë, duhen mbajtur kontaktet. Ata duhet të informojnë viktimat kur trafikantët lirohen"*(E Intervistuar Nr. 15); *"Mbështetja maksimale e familjes, e policisë e shtetit"* ( E Intervistuar nr. 2); *"Të flasin më shumë, të na dëgjojnë, të jenë më shumë afër nesh"*(E Intervistuar Nr. 13).
- Shtrirja e mbrojtjes pas hetimeve – 2 të intervistuarat. *"Ata mund ta mbrojnë për momentin sa të mbarojnë hetimet, por risku për tu riviktimizuar është përsëri"* (E Intervistuar Nr. 3 *"Policia duhet ti monitorojë viktimat, të vazhdojë ti mbrojë"* (E Intervistuar Nr. 18)

15 Pyetja 20

Ne konsiderojmë se ajo çka sugjerohet për mbrojtje në familje është një mobilizim i të gjitha institucioneve, duke përfshirë Policinë, megjithatë Policia është institucioni që konsiderohet më përgjegjës për mbrojtjen në familje.

Informacioni tregon se është e nevojshme të eksplorohehen kushtet në të cilat viktimat janë kthyer në familje- vlerësimet dhe arranzhimet që janë bërë, përfshirë informacionin se ku ndodhet trafikanti, cilat janë masat e ruajtjes fizike që do merren etj.

Fusha të tjera që duhet të eksplorohehen më tej janë rreziku që i vjen familjes nga kthimi në shtëpi i viktimës dhe benefitet afatshkurtra dhe afatgjata të kthimit në familje.

Edhe në koto përgjigje mbi, mbrojtjen në familje nuk ka ndonjë referim mbi kapacitetet logjistike të Policisë. Një vlerësim mund të jetë i nevojshëm për të krahasuar këto pritje të viktimave për mbrojtje me kapacitetet logjistike të policisë.

#### 4.6 Mbrojtja e vetë familjes

Përgjigjet e pyetjes: *Çfarë mendoni se duhet të bëjë policia për të mbrojtur familjet e viktimave të trafikimit nga kërcënimet dhe sulmet prej trafikantëve të tyre?*<sup>16</sup> rinxjerrin në pah pritjet që Policia të mbrojë vetë viktimën. Nga 14 përgjigje, vetëm në 5 referohet tek familja.

Tre prej të intervistuarve sugjerojnë që familja të ndihmohet të lëvizë jashtë :

*“Në qoftë se kërcënimi është i lartë që as policia nuk e ndalon atëherë do ishte shumë mirë që të ndihmohen për të lëvizur jashtë shtetit për një periudhë kohore”* (E Intervistuar Nr. 7); *“Më e mira është që të jenë në një vend ku nuk kanë shumë kontakte me njerëzit, jashtë, në një vend më të sigurt ose diku jashtë qytetit”* (E Intervistuar Nr. 8); *“Nëse situata është serioze, duhet të largohet jashtështetit”* (E Intervistuar Nr. 14)

Dy sugjerojnë se Policia duhet të jetë afër fizikisht me familjen: *“Policia, që të mbrojë familjen e asaj goce ose djali.. të vendosë roje, të jetë në kontakt me atë familje* (E Intervistuar Nr. 11); *“Policia duhet ti mbrojë, ti monitorojë”* (E intervistuar Nr.18)

Mungesa e sugjerimeve të mirëfillta për krejt familjen mund të jetë e lidhur me: a) të intervistuarit nuk janë duke jetuar me familjen; b) konsiderojnë se nëse mbrohet personi i rrezikuar është e gjithë familja e mbrojtur; c) konsiderojnë se masat për familjen janë të vështira për t'u marrë.

16 Pyetja 21



## Roli i trafikantëve në drejtësi

### 5.1 Metodatat dhe ndikimi i trafikantëve tek viktimat

Në studim nuk ka patur pyetje direkte lidhur me ndikimin që trafikantët kanë mbi institucionet e drejtësisë. Megjithatë në përgjigjet e dhëna ndaj Pyetjes nr.3: *Pse mendoni që të rinjtë e kanë të vështirë ose hezitojnë të shkojnë në polici?* Ka informacion mbi ndikimin e trafikantëve që vjen në formën e kërcënimeve, hakmarrjes, presionit: *"disa mund të kenë frikë të familja e vet sepse në qoftë se ai futet në burg nuk do rrijë pa marrë hak jashtë"* ( E Intervistuar Nr. 11); *"(viktimat) mund të kenë kërcënime"* ( E Intervistuar Nr 10) ; *"Sepse trafikantët nuk janë kapur – ata ushtrojnë presion ndaj viktimave"* ( E Intervistuar Nr. 16); *"Është e vështirë për to pasi mund të jenë të kërcënuar, nuk e dinë se çfarë do të ndodhë më pas"* ( E Intervistuar Nr. 18).

### 5.2 Dënimet e trafikantëve dhe roli i mosdënimit

Nuk ka patur pyetje direkte lidhur me dënimin e trafikantëve. Megjithatë, dënimi i trafikantëve del si temë e rëndësishme në përgjigjet e dhëna ndaj pyetjeve Nr. 10 dhe Nr. 21.

Duke iu përgjigjur Pyetjes nr. 10: *A keni ndonjë sugjerim se si mund të rritet besimi mes të rinjve viktimat dhe këtyre institucioneve?* Një prej të intervistuarave thotë: *"ato rregulla që thuhet nga kryeministri në televizor dhe nga presidenti mos të ngelen veç fjalë por të zbatohen që ai person që është për tu dënuar të dënohet ashtu si e meriton. ...sot gjykohet më shumë i pafajshmi se sa ai që ka faj (E Intervistuar 7)*. Një e intervistuar tjetër thotë: *"Të vendosin drejtësi, çdo trafikant duhet të përballet me drejtësinë, jo ta mbajnë një natë në komisariat dhe pastaj ta nxjerrin... pasi ai do trafikojë vajza të tjera ( E Intervistuar 17)*

Roli i trafikantëve kur ata nuk dënohen del në pah edhe në përgjigjet ndaj pyetjes 21: *Çfarë mendoni se duhet të bëjë policia për të mbrojtur familjet e viktimave të trafikimit nga kërcënimet dhe sulmet prej trafikantëve të tyre?*


Përgjigjet tregojnë për rëndësinë e kapjes dhe burgosjes së trafikantëve dhe informimit të viktimave. E Intervistuar Nr. 12 thotë: *"Duhet të kapin trafikantët ti fusin brenda"*. E Intervistuar nr. 17 thotë: *"Viktimat duhet të informohen për lëvizjet e trafikantit. Nuk mund të mjaftohen me "ne do të të mbrojmë, mos u shqetëso!"* E Intervistuar nr. 5

konsideron se Policia duhet të kapë trafikantët: ***"të kapi trafikantët dhe mos ti lerë jashtë pasi ai mund të bëjë të njëjtën gjë përsëri me dikë tjetër"***

Informacioni I mbledhur sugjeron se sistemi i drejtësisë duhet të njoftojë hap pas hapi për çdo veprim që do ndërmerret ndaj trafikantit. Viktima duhet të informohet për çdo informacion që ka të bëjë me çështjen. Dhe jo vetëm kaq. Në rast se për arsye të ndryshme trafikanti ka dalë nga burgu, viktima duhet informuar dhe nëse ndihet e rrezikuar t'i ofrohet mbështetje.

## Komunikimi dhe sjellja

Nga 18 pjesëmarrëse në studim, 17 i janë përgjigjur pyetjes se si janë ndjerë në ambientet e Policisë. Shumica e kanë përcaktuar eksperiencën<sup>17</sup> si të keqe: 6 të reja e kanë përcaktuar eksperiencën si "shumë të keqe", 7 si "të keqe", 2 si "as të mirë as të keqe, dhe vetëm 2 si "të mirë".



*Fig. 10 Eksperiencat në Polici*

Është tepër shqetësuese që 13 nga 18 të intervistuar e quajnë eksperiencën e tyre në Polici si të keqe ose shumë të keqe. Në anketë nuk ka patur pyetje për të kërkuar shpjegime për arsyet e zgjedhjeve. Pyetja më tej ka qenë lidhur me sjelljet ofenduese. Kjo mbase ka penguar që të mblidhet informacion mbi çfarë tjetër specifikisht, përveç sjelljeve ofenduese e bën të keqe eksperiencën në Polici.

### 6.1 Sjelljet që përjetojnë si ofenduese

Nga 18 pjesëmarrës në studim, 6 nuk i janë përgjigjur pyetjes se çfarë sjelljesh mund të përjetojnë si ofenduese nga të rinjtë viktimë në ambientet e policisë<sup>18</sup> ndërsa 1 është

<sup>17</sup> Pyetja 4: Si mendoni, çfarë do të thoshin të rinjtë, si do ta përshkruanin eksperiencën / përjetimin e tyre kur kanë shkuar në polici për mbështetje dhe drejtësi?

<sup>18</sup> Pyetja Nr. 5



shprehur se është ndjerë mirë në ambientet e Policisë. 2 nga 6 kanë preferuar të japin përgjigjen ' nuk mundem të flas'.

Të gjitha 11 të intervistuarat e tjera kanë thënë se në kontaktin e parë në ambientet e Policisë, janë ndjerë të ofenduar, nuk janë besuar , janë riviktimizuar, nuk u është marrë parasysh denoncimi, me to është përdorur fjalor tallës dhe ofendues, jënë bërë fajtores për atë që u ka ndodhur. Disa prej përgjigjeve të Policisë të informuara janë: *"a je e sigurt që kjo ngjarje ka ndodhur apo po e shpik?"* (E Intervistuar Nr. 8) *"Ik moj goce ik në shtëpi- fjala e parë që thonë"* (E Intervistuar nr, 12) , *"Vet ka dasht....pse je marrë me këtë gjë?"* (E Intervistuar Nr. 11)

Konsiderohen po ashtu si ofenduese:

- kërkimi për detajet: *"detajet më të vogla, duke e bërë të ndihet keq, duke bërë shumë pyetje në një kohë shumë të keqe emocionale për viktimën"* ( E Intervistuar Nr. 5);
- kërkimi për të kaluarën: *"Kur pyeten për të kaluarën"* ( E intervistuar Nr. 18)

Numri i lartë edhe lloji i sjelljeve ofenduese të informuara janë shqetësuese. Ne konsiderojmë se për të tilla sjellje duhen marrë masa menjëherë.

## 6.2 Marrja në pyetje shumë herë

16 të intervistuarat i janë përgjigjur pyetjes *"A mendoni se gjatë procesit të hetimit dhe gjyqimit penal viktimat e trafikimit pyeten më shumë se një herë nga policët, prokurorët dhe gjykatësit? Si mendoni se ndjehen të rinjtë lidhur me këtë praktikë?"*

Askush prej 16 nuk i kanë kthyer përgjigje pjesës së parë të pyetjes. Të gjithë kanë kaluar në dhënien e përgjigjes së pjesës së dytë, mënyrës se si ndjehen.

6 nga 16 qëi janë përgjigjur pyetjes janë shprehur se kjo ka lidhje me ripërjetimin e ngjarjeve traumatike.

Sipas të intervistuarve marrja në pyetje shumë herë bën të kundërtën e asaj që ka për qëllim : në vend që të japë një pamje të qartë të ngjarjeve e prish atë: *"Mua më kanë pyetur 10 herë mos më shumë por për mendimin tim nuk është e mirë sepse një person që është në një gjendje shumë të keqe që ka kaluar një traumë ta pyesësh 10 herë, ai të 10 herët do të thotë diçka ndryshe sepse ai as vetë nuk mban mend saktësisht ngjarjen."* ( E Intervistuar Nr. 7) *"Normalisht që është pak e vështirë që në të njëjtën kohë, d.m.th. në shumë faza ta thuash të njëjtën gjë sepse të kthehet e njëjta histori, i njëjti përjetim, por është gjë që ato e kanë për detyrë që ta bëjnë që të zbulojnë nëse ato (viktimat) qëndrojnë te e njëjta fjalë apo jo që të zbulojnë nëse është e vërtetë apo jo"* ( E Intervistuar Nr. 8);

Me përjashtim të një të intervistuarë që shprehet shkurt – *"Ndjehen keq, është normale"* (E Intervistuar Nr. 16), të intervistuarat e tjera përshkruajnë se pse marrja në pyetje shumë here është keq. Një nga të intervistuarat, Nr. 10, përmbledhtas shprehet *"Të prekur, kanë frikë, të kërcënuar, sikur ka ardh fundi, nuk kanë forcë, ndjehen të turpëruar."*

Të intervisturat e tjera informojnë po ashtu se ripyetja :

- I bën të ndihen të pambrojtur dhe të pasigurt: ***“Ata ndihen të pambrojtur, normal të pasigurt sepse supozohet që ti po shkon për mbrojtje dhe gjen një realitet tjetër”*** ( E Intervistuar Nr. 1);
- U shkakton ose u shton frikën: ***“ka ato emocionet dhe shtohet presioni psikologjik dhe frika të them apo mos të them të gjitha”*** ( E Intervistuar Nr.7)
- U jep ndjesinë që duan t’i kapin në gabim , t’i bëjnë fajtorë: ***“Mua më kanë pyetur shumë herë, nga njerëz të ndryshëm vetëm e vetëm për të parë nëse gjërat që thoja ishin të vërteta, duan të të kapin gabim. Dhe kjo i bën të ndjehen shumë keq pasi ato riviktimizohen duke e përsëritur një ngjarje shumë herë.*** ( E Intervistuar Nr. 6);
- U shkakton lodhje: ***“Viktimat nuk besohen, ato pyeten vazhdimisht nga persona të ndryshëm, policia ve në dyshim fjalët e viktimës-herën tjetër nuk e the këtë gjë-viktima lodhet nga kjo procedurë”*** ( E intervistuar Nr.17);
- I bën të ndjehen tëbezdatur;
- U shkakton një stres qëështë i krahasueshëm me stresin e shkakuar nga trafikantët dhe i shtohet atij: ***“Mendoj se ndihen në stres nën presionin e policisë edhe nën presionin e personit që e ka çuar në trafikim ( E Intervistuar Nr. 11)***

Në përgjigje të kësaj pyetje kanë ardhur edhe rrethana të tjera të marrjes në pyetje të cilat përjetohen si negative. Sipas njërës prej të intervistuarave, këto janë pyetja për gjëra të ndjeshme dhe pyetja në sy të shumë njerëzve: ***“Mendoj se ndihen keq kur pyeten për gjëra të ndjeshme dhe në sy të shumë njerëzve”*** ( E Intervistuar Nr. 14)

Siç është vënë në dukje më lart, të gjitha të intervistuarat që janë përgjigjur nuk i janë përgjigjur pjesës së parë të pyetjes, pra mund të themi që e kanë marrë të mirëqenë që do ripyeten. Është e dukshme megjithatë që ripyetja vjen edhe për shkak të mungesës së besimit tek thëniet. Në përgjigje duket gjithashtu një lloj qëndrimi “në pozicion mbrojtje” – përgjigjet përmbajnë arsyetimin se për shkak të stresit psikologjik viktimat nuk është në gjendje të rikujtojë ngjarjet që i kanë ndodhur.

Nëse do të kishte informacion lidhur me “vullnetarizmin” e kontaktit të të intervistuarave me autoritetet, do të mund të eksplorohej më shumë edhe ripyetja për shkak të mosbesimit. Kjo sepse në rast se viktimat do t’i drejtohej vetë autoriteteve, atëherë mbase edhe nuk do të kishte këtë nivel mosbesimi ndaj saj/tij.

Është e paqartë dhe duhet eksploruar më tej se pse autoritetet, edhe pse nga eksperiencia duhet ta dijë se viktimat për shkak të traumave e humbasin memorjen, përsëri vazhdon të ushtrojë presion për të kërkuar fakte dhe hollësi nga viktimat.

### 6.3 Fokusimi tek informacioni që është i vlefshëm për hetimin

Studimi ka mbledhur informacion edhe mbi praktikën e marrjes së informacionit që nuk është i rëndësishëm për hetimin.

11 prej të intervistuarve / anketuarve shprehen se policia fokusohet/ mbledh vetëm informacion që është i vlefshëm për hetimin ndërsa 6 shprehen se policia mbledh informacion/ pyet edhe për gjëra të tjera të cilat nuk kanë lidhje me hetimin.

8 prej të intervistuarve nuk i përgjigjen pyetjes nr. 14: *“Çfarë informacioni tjetër mund ti pyesë policia viktimat që nuk është i rëndësishëm për hetimin?”. 4 prej të intervistuarve janë përgjigjur se Policia pyet për gjëra personale.*

Sipas dy prej të intervistuarve, pyetja për gjëra personale bëhet me qëllim për të bërë viktimën fajtorë: *“ Pyesin për gjëra personale, pa lidhje me çështjen, përdorin mënyra e mënyra që mos t’i besojnë fëmijës”. (E Intervistuar Nr. 15); “Nuk mund ta them me siguri, e di që kur një viktimë shkon në polici ajo nuk besohet, vazhdojnë dhe e pyesin “ a je e sigurt?” shko dhe mendohu dhe njëherë ,, je shumë e vogël për të pyetur për këto gjëra. Bëjnë pyetje që nuk ka lidhje me çështjen, bëjnë komente që të fajësojnë ty” (E Intervistuar Nr. 17)*

Sipas një të intervistuarve, pyetja lidhur me njohjen me trafikantin është pyetje pa lidhje me hetimin: *“Pyesin në fillim për çështjen pastaj kalojnë në gjëra personale , për familjen për trafikantin nga është nga vjen si e njohe etj. ( E Intervistuar Nr. 3)*

Në përgjigje ka dalë edhe shqetësimi që pyetjet personale kanë të bëjnë me sjellje abuzive : *“mund të jetë edhe ndonjë polic maniak po normalisht ai pyet në fillim për trafikimin por që Zot mos mund të dalë edhe ashtu si të thashë” ( E intervistuar Nr. 1)*

Ne konsiderojmëse numri i lartë i atyre që nuk ka dhënë përgjigje mund të tregojnë që ose policia nuk pyet për gjëra pa lidhje me hetimin, ose që nuk është shumë e qartë se çfarë është e lidhur me hetimin. Përgjigjet lidhur me pyetjet personale mund të tregojnë që ka qenë e nevojshme që përpara se të bënim pyetjen, duhet ose të pyesnim se çfarë konsiderohet personale ose të jepnim një përkufizim se çfarë është një pyetje personale

## 6.4 Mbështetja për t’u ndjerë më mirë

12 prej të intervistuarve/ të anketuarve mendojnë se viktimat mund të ndjehen në presion nga Policia për të raportuar krimet e trafikimit dhe për të dhënë deklarata.

Ajo çka informohet se mund të bëjë Policia për ti bërë viktimat e trafikimit të ndjehen më mirë dhe të mbështetur në situata të tilla është:

- Të kapë trafikantët – Informohet nga 2 të intervistuar;
- Të jenë njerëzorë, të mos përdorin dhunë - informohet nga 2 të intervistuar. *“Të tregohen më të afërt me viktimën më të kuptueshëm dhe t’i bëjnë gjërat ashtu siç duhet në mënyrë pak më njerëzore” ( E Intervistuar Nr. 7);*
- Të japin mbështetje dhe ndihmë - Informohet nga 4 të intervistuar; *“ Ti ndihmojë sa më shumë mos të rrinë duke ngrënë fara dhe pizza nëpër rrugë. Ata të rrugores i shof vetëm duke ngrënë fara dhe pizza, pepsi, redbulla, dalin marrin lekë, çfarë nuk po shoh nga këta polica” ( E Intervistuar Nr. 11)*
- Të kenë komunikimin e duhur - Informohet nga 3 të intervistuar. *“Të flasë me qetësi , të mos prekë tek gjërat që asaj i dhembnin, ta marrë dëshminë në një mënyrë që ajo mos të lëndohet përsëri, të mos e bejë të ndjehet fajtorë, si të ishte një psikolog i dytë.” ( E Intervistuar Nr.5) “Të komunikojnë mirë, me qetësi” ( E Intervistuar Nr. 18)*

- Të motivojë për të raportuar – Informohet nga 1 e intervistuar. *"duhet të të motivojnë për të raportuar, të meren sa më shumë me viktimën, pasi kam parë dhe gazetarë që nuk e kanë fokusin tek viktimat si ta ndihmojnë. Po meren me llafë kot. Nuk është diçka që kalon shpejt ,do ngeli gjithë jetën."* ( E Intervistuar Nr.6 )
- Të japë siguri - Informohet nga 1 e intervistuar *"Ti mbështesin të ndihen të sigurt"* ( E Intervistuar Nr. 2)
- Të mbajë të informuar- Informohet nga 1 e intervistuar *"Policia duhet ta mbajë të informuar për çështjen"* (E Intervistuar Nr. 3)
- Të ketë staf psikologë–Informohet nga 2 të intervistuar. *" Në rastin tim në vend që unë të tregoj historinë time të një oficeri dhe kam treguar të një psikologu dhe jam ndjerë më mirë normalisht edhe komisarati e ofron këtë ndihmë që kanë edhe psikologët e tyre. (E Intervistuar Nr. 8) "Ti ndihmojnë për të folur me një psikolog dhe me një person që ai ka besim , të flasë sa më shumë , viktimat duhet të ndjehen mirë. ( E Intervistuar Nr. 10);*
- Të ketë staf të gjinisë femër – Informohet nga 1 e intervistuar;
- Nuk duhet të pyesë për gjëra personale – Informohet nga 1 e intervistuar;
- Të kuptojnë diferencat mes moshave- informohet nga 1 e intervistuar

## Konkluzione dhe rekomandime

Përgjigjet tregojnë se ka mungesë informacioni dhe paqartësi lidhur me çfarë pritet prej viktimave apo autoritetet për mbarëvajtjen e çështjeve dhe vendosjen e drejtësisë në të gjitha hallkat e sistemit. Është e nevojshme që të zhvillohen aktivitete të informimit mbi të gjitha hallkat e procesit dhe përgjegjësit edhe për të rinjtë edhe për autoritetet. Informacioni i mbledhur sugjeron se besimi i të rinjve tek autoritetet ndikohet fort nga qëndrimi i autoriteteve të drejtësisë ndaj tyre, e sidomos nga besimi që autoritetet tregojnë ndaj thënieve e deklaratave të të rinjve. Është e nevojshme që hulumtimet e mëvonshme të eksplorojnë se si mund të rritet besimi i autoriteteve të të rinjtë. Komunikimi dhe sjellja e Policisë ka potencial të dëmtimit të viktimave dhe të largimit të viktimave nga kërkimi i drejtësisë. Punonjësit e sistemit të drejtësisë duhet të vlerësohen për qëndrimet ndaj viktimave të krimit dhe të mbahen përgjegjës për dëmtimet e shkaktuara.

Viktimat nuk ndihen të sigurt pikërisht në institucionet e drejtësisë dhe vetëm me punonjësit e sistemit të drejtësisë. Gjetjet e studimit duhen bërë të njohura menjëherë për të mundësuar sensibilizimin dhe ndryshimin. Qëndrimi i viktimave në ambjentet e institucioneve të drejtësisë dhe vetëm me policinë prokurorinë gjykatën duhet të minimizohet sa më shumë që është e mundur – intervistat, dëshmitë duhet të merren në ambiente miqësore.

Nuk ka qenë qëllim i studimit dhe si pasojë nuk është mbledhur informacion se sa dhe si situata e përgjithshme e drejtësisë ndikon në drejtësinë për rastet e dhunës seksuale dhe trafikimit. Megjithatë, të intervistuarat i referohen shumë kësaj situatë në përgjigjet e tyre. Në të ardhmen duhet të hulumtohen lidhjet mes dhe veçoritë e situatës së drejtësisë në përgjithësi dhe situatës së drejtësisë në rastet e abuzimit seksual dhe trafikimit për shfrytëzim seksual.

Sugjerimet lidhur me rritjen e nivelit të besimit të Policisë kanë të bëjnë me ndryshime në sjellje dhe qëndrime dhe jo shumë në logjistikë. Ndërsa është e nevojshme të zhvillohen trajnime dhe aktivitete ndërgjegjësimi për Policinë, është e nevojshme të zhvillohet një vlerësim lidhur me mangësitë logjistike që ndikojnë në marrëdhëniet mes viktimave dhe Policisë.

Sistemi i drejtësisë për viktimat është ndërtuar në mënyrë të tillë që mbarëvajtja e rasteve varet shumë nga komunikimi mes Policisë dhe Prokurorisë. Ky studim nuk mundi të fokusohet më tej në këtë marrëdhënie. Është e nevojshme që të eksplorohej më tej eksperiencat dhe dëshmitë e viktimave lidhur me transferimin e rasteve nga Policia në Prokurori.

Paragjykimet ndikojnë në bashkëpunimin e viktimave me drejtësinë. Është e nevojshme që të zbulohen më tej se cilat janë paragjykimet dhe se simund të trajtohen ato.

Ngecjet e çështjeve konsiderohen tëshkaktuara nga niveli i lartë i mosbesimit tek viktimat, paragjykimet ,mungesa e informacionit për të drejtat e viktimës. Është e nevojshme që të bëhen përpjekje për të rritur besimin mes viktimave dhe profesionistëve të drejtësisë penale. Kjo kërkon angazhim për të luftuar paragjykimet duke bashkëpunuar me autoritetet. Përpjekjet duhet të kombinohen me punën me viktimat për të mësuar të drejtat e tyre dhe për t'i mbështetur që të kërkojnë të drejtat e tyre.

# Referencat

- Beckett, H. dhe Warrington, C. (2015) *'Making justice work: experiences of criminal justice for children and young people affected by sexual exploitation as victims and witnesses (Të vësh drejtësinë në funksionim: përvojat e drejtësisë penale për fëmijët dhe të rinjtë e prekur nga shfrytëzimi seksual si viktimë dhe dëshmitarë'*. Luton: Universiteti i Bedfordshire.
- Braun, V dhe Clarke, V (2006) Using thematic analysis in psychology. *Qualitative Research in Psychology* (Përdorimi i analizës tematike në psikologji: kërkimi cilësor në psikologji) 3 (2): 77-101.
- D'Arcy, K, Warrington, C. dhe Cody, C. (n.d.). Ethical Guidance on children and young people's participation for LEAP partners. (Udhëzues etik për pjesëmarrjen e të miturve dhe të rinjve si partnerë të projektit LEAP) <https://www.our-voices.org.uk/assets/documents/LEAPParticipationEthics-1.pdf>
- Departamenti i Shëndetësisë, Arsimit dhe Mirëqenies; Komisioni Kombëtar për Mbrojtjen e Njeriut si Objekt i Kërkimeve Biomjekësore dhe të Sjelljes (2014). Raporti Belmont. Ethical principles and guidelines for the protection of human subjects of research (Parimet dhe udhëzimet etike për mbrojtjen e njeriut si objekt të kërkimit). *J Am Coll Dent*. 81(3): 4-13. PMID: 25951677.
- Komisioni Evropian (KE). *Drejtësia miqësore me fëmijët: Fusha tematike 4 e strategjisë së BE-së për të drejtat e fëmijës*. [https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/rights-child/child-friendly-justice\\_en](https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/rights-child/child-friendly-justice_en)
- Liefaard, T. (2020). Child-friendly Justice and Procedural Safeguards For Children in Criminal Proceedings: New Momentum for Children in Conflict with the Law? (Drejtësia miqësore me fëmijët dhe masat procedurale për të miturit në ndjekje penale: moment i ri për të miturit në konflikt me ligjin?) *Bergen Journal of Criminal Law& Criminal Justice* 8. 17. 10.15845/bjclcj.v8i1.3188.
- Peace, D. (2020). Our Voices Too Toolkit: Sexual Violence. (Paketa e masave për "Edhe Zërat Tanë". Dhuna Seksuale.) <https://www.our-voices.org.uk/assets/documents/Sexual-violence-podcast.mp3>
- Save the Children (2018). Participatory action research with adolescents affected by the Syria crisis in Egypt and Lebanon: PAR Lessons learned and 'How to' guide. (Studimi për veprim me pjesëmarrje të adoleshentëve të prekur nga kriza në Siri në Egjipt dhe Liban: Mësimet e nxëna nga PAR dhe udhëzues "Si të") [https://resourcecentre.savethechildren.net/node/13182/pdf/par\\_lessons\\_learned\\_report\\_hoë\\_to\\_guide.pdf](https://resourcecentre.savethechildren.net/node/13182/pdf/par_lessons_learned_report_hoë_to_guide.pdf)
- Snowdon, W., Schultz, J. dhe Sëinburn, B. (2008) Problem and solution trees: a practical approach for identifying potential interventions to improve population nutrition. (Pema e problemeve dhe zgjidhjeve: një qasje praktike për identifikimin e ndërhyrjeve të mundshme për përmirësimin e ushqyerjes së popullsisë) *Health Promotion International*, 23 (4): 345-353, <https://doi.org/10.1093/heapro/dan027>
- Strauss, A. dhe Corbin, J. (1998) *Basics of qualitative research: Grounded theory procedures and techniques (Procedurat dhe teknikat e teorisë së bazuar në të dhëna) (2nd ed)*. Newbury Park: Botimet Sage.
- Surtees, R. dhe Johnson, L. S. (2021) *Special and Additional Measures for Child Trafficking Victims: A Practitioner Guide. (Masa shitesë dhe të veçanta për fëmijët viktimë të trafikimit: Udhëzues për profesionistët)* Bangkok: Zyra Rajonale Mbështetëse e Procesit të Balit (RSO) dhe Uashington, D.C.: Instituti NEXUS.
- UNICEF (2019) Studimi për Veprim me Pjesëmarrje të të Rinjve në Rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut: Manuali i Trajnuesit të Trajnuesve. <https://www.unicef.org/mena/media/4951/file/MENA-PAR-ADAP-April2019.pdf.pdfUNICEF>



# Aneks 1. Pyetësori

## “Hapat e vegjël mund të bëjnë ndryshim të madh” Protokolli Anketimit të Projektit

### Hapi 1: Prezantimi dhe marrja e lejes

### Hapi 2: Pyetje për nxemje

Faleminderit që pranove të marrësh pjesë në anketim. Si je?

### Hapi 3. Të dhëna demografike

1. Sa vjeç je? \_\_\_\_\_
2. Në cilin qytet jeton? \_\_\_\_\_
3. Gjinia? *Bëj një shenjëtë lutem tek:* mashkull/femër /jo kështu mashkull/femër
4. Çfarë arsimi ke?  
*Bëj një shenjëtë lutem tek: Arsim 9vjeçar/ shkollë e mesme e përgjithshme /shkollë e mesme profesionale / universitet*
5. Sa kohë je ndihmuar / të janë dhënë shërbime?

### Hapi 4: Pyetjet e Anketimit

1. Siç e dini, sondazhi është për përvojat e të rinjve në kërkimin e mbështetjes dhe drejtësisë pasi kanë përjetuar trafikim për shfrytëzim seksual dhe dhunë seksuale. Kush mendoni se preket më shpesh nga këto krime?  
Meshkujt/femrat/ të dyja gjinitë?
2. Sa të lehtë e kanë të rinjtë që janë prekur nga trafikimi të shkojnë tek policia?  
*Ju lutem përdorni përshkallëzimin më poshtë*  
  
1: Shumë të lehtë   
2: Të lehtë   
3: As të lehtë as të vështirë   
4: Të vështirë   
5: Shumë të vështirë
3. *Nëse vutë shenjë tek 4 ose 5*, pse mendoni që të rinjtë e kanë të vështirë ose hezitojnë të shkojnë në polici?

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

4. Si mendoni, çfarë do të thoshin të rinjtë, si do ta përshkruanin eksperiencën / përjetimin e tyre kur kanë shkuar në polici për mbështetje dhe drejtësi?



**Ju lutemi përdorni përshkallëzimin më poshtë:**

- 1: Shumë të mirë
- 2: Të mirë
- 3: As e mirë as e keqe
- 4: Të keqe
- 5: Shumë të keqe

- 5.** Çfarë çështjesh apo sjelljesh mund të përjetohen si ofenduese nga të rinjtë viktimat?

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

- 6.** Në cilën prej shkallëve të drejtësisë penale ngecin çështjet e të rinjve që pasi viktimizohen kalojnë nëpër sistemin e drejtësisë penale?

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

- 7.** A mendoni se të rinjtë që janë prekur nga trafikimi ndjehen të sigurt kur janë në kontakt me:

a) Policinë/ Policët: Po/Jo

A mundeni, ju lutem, të shpjegoni përgjigjen tuaj këtu?

7/b A mendoni se të rinjtë që janë prekur nga trafikimi ndjehen të sigurt kur janë në kontakt me:

b) Prokurorinë/Prokurorët : Po/Jo

A mundeni, ju lutem, të shpjegoni përgjigjen tuaj këtu?

7.c A mendoni se të rinjtë që janë prekur nga trafikimi ndjehen të sigurt kur janë në kontakt me:

c) Gjykatësit: Po/Jo

A mundeni, ju lutem, të shpjegoni përgjigjen tuaj këtu?

- 8.** Sipas opinionit tuaj , çfarë mund të bëjnë institucionet e zbatimit të ligjit që ti bëjnë të rinjtë të ndjehen më të sigurt?

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

- a) Sugjerimet për policët:
- b) Sugjerime për prokurorët:
- c) Sugjerime për gjykatësit:

**9.** Sa mendoni se i besojnë të rinjtë prekur nga trafikimi institucioneve si më poshtë:

9.a Policisë

Nga 0 te 5 sa i besojnë Policisë ( 0 është nuk i besojnë fare, 5 është i besojnë maksimalisht)

0.  1.  2.  3.  4.  5.

A mund të thoni se pse bëtë këtë zgjedhje

9.b Prokurorisë

Nga 0 te 5 sa i besojnë Prokurorisë ( 0 është nuk i besojnë fare, 5 është i besojnë maksimalisht)

0.  1.  2.  3.  4.  5.

A mund të thoni se pse bëtë këtë zgjedhje

9.c Gjykatësve

Nga 0 te 5 sa i besojnë Gjykatësve ( 0 është nuk i besojnë fare, 5 është i besojnë maksimalisht)

0.  1.  2.  3.  4.  5.

A mund të thoni se pse bëtë këtë zgjedhje

**10.** A keni ndonjë sugjerim se si mund të rritet besimi mes të rinjve viktime dhe këtyre institucioneve?

a) Sugjerimi për policinë/ policët:

b) Sugjerime për prokurorët:

c) Sugjerime për gjykatësit

**11.** A mendoni se gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit penal viktimat e trafikimit pyeten më shume se një herë nga policët, prokurorët dhe gjykatësit? Po/Jo

**12.** Si mendoni se ndjehen të rinjtë lidhur me këtë praktikë?

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

**13.** A mendoni se policia e pyet viktimën vetëm për informacionin që është i rëndësishëm për hetimin? Po/Jo

**14.** Nëse ju bëtë shenjë tek 'Jo', çfarë informacioni tjetër mund të pyesë policia viktimat që nuk është i rëndësishëm për hetimin?

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

**15.** A mendoni se disa viktima mund të ndjehen në presion nga policia për të raportuar krimet e trafikimit dhe për të dhënë deklarata? Po/Jo

**16.** Çfarë mund të bëjë policia për të bërë viktimat e trafikimit të ndjehen më mirë dhe të mbështetur në situata të tilla?

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

**17.** A mendoni se procesi i kalimit nëpër procedurat e hetimit dhe gjykimin penal mund të jetë traumatizues për të rinjtë e prekur nga trafikimi? Po/Jo

Ju lutem shkruani përgjigjet tuaja këtu:

**18.** A mendoni që të rinjtë që kanë qenë të trafikuar janë të sigurt kur kthehen në familjet e tyre? Po/Jo

**19.** A mendoni se policia i mbron të rinjtë që janë kthyer në familje nga kërcënimet dhe sulmet prej trafikantëve të tyre? Po/Jo

**20.** Çfarë mendoni se do ta rriste sigurinë e të rinjve pasi janë kthyer në familjet e tyre?

Ju lutem shkruani sugjerimet tuaja këtu:

**21.** Çfarë mendoni se duhet të bëjë policia për të mbrojtur familjet e viktimave të trafikimit nga kërcënimet dhe sulmet prej trafikantëve të tyre?

Ju lutem shkruani sugjerimet tuaja këtu:

**22.** Cili është mesazhi më i rëndësishëm që ju doni të jepni institucioneve të drejtësisë penale?

**Tiranë 2022**